



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 211

Tiranë – E enjte, 13 nëntor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 390, datë 11.11.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 25231
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 647, datë 7.11.2025	Për miratimin e marrëveshjes së dhurimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë..... 25231
Urdhër i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 147, datë 31.10.2025	Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit..... 25241
Urdhër i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 148, datë 31.10.2025	Për raportimin e të dhënave dhe ecurisë së çështjeve gjyqësore..... 25242
Urdhër i ministrit të Arsimit nr. 578, datë 11.11.2025	Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Orjana Osmani..... 25243
Urdhër i ministrit të Arsimit nr. 579, datë 11.11.2025	Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Herida Duro..... 25244
Urdhër i ministrit të Arsimit nr. 580, datë 11.11.2025	Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit, znj. Armela Baka..... 25246
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1139, datë 6.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Irlandës..... 25248
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1140, datë 6.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës..... 25249

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1141, datë 6.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	25250
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1142, datë 6.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës.....	25251
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1143, datë 6.11.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	25252
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 16144, datë 10.11.2025	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	25253
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50, datë 25.9.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 10-2015-1185(523), datë 19.5.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2024-1183, datë 19.3.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën kompetente të apelit.....	25253
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 779, datë 31.10.2025	Për miratimin e rregullave për kriteret dhe procedurën e emërimit në pozicionin e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë.....	25260
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 5713, datë 26.9.2025	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Fllanza Duki.....	25287

**DEKRET****Nr. 390, datë 11.11.2025****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93, të Kushtetutës; të neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Damaljana Lefter Maliqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM**Nr. 647, datë 7.11.2025****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
DHURIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS
SË TURQISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së dhurimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

MARRËVESHJE DHURIMI**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE REPUBLIKËS SË TURQISË**

Republika e Shqipërisë (në vijim referuar si “Përfituesi”) dhe Republika e Turqisë (në vijim referuar si “Dhuruesi”) (në vijim referuar së bashku si “Palët”),

duke shprehur kënaqësinë e tyre për nivelin aktual të miqësisë dhe të marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Palëve dhe dëshirën për t’i forcuar më tej këto marrëdhënie;

duke marrë parasysh dispozitat e Traktatit të Miqësisë, Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë, i cili është nënshkruar më 1 qershor 1992,

janë dakordësuar si vijon:

**KREU I
TRANSFERIMI DHE DORËZIMI I
AEROPLANIT****Neni 1**

Të gjitha të drejtat, titulli dhe interesat që lidhen me Aeroplanin, të dhënat teknike të të cilit janë paraqitur në shtojcën 1, dhe i cili në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje operohet nga Türk Hava Yolları A.O. (në vijim referuar si “Operatori”), në përputhje me Autoritetin Turk të Aviacionit Civil, me një vlerë tregu prej afërsisht 11.900.000 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind mijë) dollarë amerikanë, do të transferohen te Përfituesi nga Dhuruesi pa pagesë, me qëllim forcimin e lidhjeve të miqësisë dhe të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Palëve.

Përfituesi pranon Aeroplanin e dhuruar sipas kësaj Marrëveshjeje në gjendjen e tij aktuale (“SIÇ ËSHTË”), së bashku me të gjitha mangësitë dhe pa asnjë garanci, të shprehur ose të nënkuptuar.

Neni 2

Titulli i pronësisë mbi Aeroplanin kalon te Përfituesi në momentin e dorëzimit të Aeroplanit. Rreziku për dëmtim, shkatërrim ose humbje të Aeroplanit kalon nga Dhuruesi tek Përfituesi në momentin e dorëzimit të tij.



Neni 3

Nëse, para dorëzimit, Aeroplani pëson humbje të plotë ose dëmtime të konsiderueshme, për të cilat Dhuruesi nuk është i gatshëm të mbulojë koston e riparimit, kjo Marrëveshje përfundon automatikisht, pa pasur nevojë për ndonjë veprim tjetër, në datën kur ndodh humbja e plotë ose dëmtimi i tillë i konsiderueshëm.

Në këtë rast, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Palëve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje pushojnë së ekzistuari dhe konsiderohen të shlyera, pa asnjë përgjegjësi të mëtejshme për asnjërën nga Palët – me përjashtim të detyrimeve për ruajtjen e konfidencialitetit, nëse ekzistojnë të tilla, të cilat mbeten në fuqi dhe me efekt të plotë, pavarësisht përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Dhuruesi do të transferojë titullin e pronësisë mbi Aeroplanin te Përfituesi dhe dorëzimi do të kryhet, si më poshtë:

a) Palët do t'i dorëzojnë njëra-tjetrës dy kopje të certifikatës së dorëzimit/pranimit (shtojca 2), të nënshkruara dhe të datuara, në gjuhën shqipe, në gjuhët turke dhe angleze, në lidhje me Aeroplanin.

b) Përfituesi do të hartojë, do të nënshkruajë dhe do të dorëzojë dokumentet, dhe do të zbatojë procedurat e tjera të nevojshme që Dhuruesi mund të kërkojë dhe që mund të jenë të detyrueshme, në lidhje me dorëzimin e Aeroplanit dhe me transaksionet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

c) Njëkohësisht, me nënshkrimin e certifikatës së dorëzimit/pranimit, regjistrimi i Aeroplanit do të fshihet nga regjistri turk i avionëve civilë; titulli i pronësisë do të kalojë nga Dhuruesi tek Përfituesi në vendin e dorëzimit dhe operimi i tij do të transferohet nga Operatori tek Përfituesi.

Në emër të Përfituesit, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë përgjegjëse për çështjet teknike, administrative dhe buxhetore lidhur me Aeroplanin.

Për të shmangur çdo paqartësi, Aeroplani nuk do të përdoret për qëllime ushtarake nën asnjë rrethanë.

Emri ose titulli, adresa, të dhënat e kontaktit dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm në lidhje me institucionin ose kompaninë që do të caktohet si Operator i Aeroplanit nga Përfituesi, do t'i njoftohen me shkrim Operatorit dhe Dhuruesit, sa

më shpejt të jetë e mundur, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Aeroplani do t'i dorëzohet Përfituesit në gjendjen që ka ("AS IS") dhe në vendin ku ndodhet ("WHERE IS"), në Stamboll (*Istanbul*).

Neni 6

Dokumentet teknike që do të dorëzohen së bashku me aeroplanin janë, si më poshtë:

a) Regjistrat e mëparshëm të mirëmbajtjes dhe dokumentet origjinale të dorëzimit të Aeroplanit;

b) Lista e miratuar e udhëzimeve teknike për sigurinë dhe funksionimin e Aeroplanit;

c) Lista e miratuar e zbatimeve të buletineve të shërbimit;

d) Lista e miratuar e zbatimeve të certifikatave shtesë të tipit (*Supplementary Type Certificates*);

e) Deklarata lidhur me ndonjë aksident ose incident të mundshëm të Aeroplanit;

f) Deklarata që tregojnë numrin e uljeve dhe orët e fluturimit për trupin e Aeroplanit (*Airframe*), motorët (*Engines*), shasinë (*Landing Gear*) dhe njësinë ndihmëse të fuqisë (APU);

g) Deklarata që tregojnë punimet e papërfunduara ose të shtyra (*deferred works*).

Neni 7

Data e dorëzimit të Aeroplanit do të përcaktohet nga Dhuruesi, duke marrë parasysh gjendjen teknike të Aeroplanit dhe disponueshmërinë e Përfituesit, me kusht që të jenë hartuar dhe nënshkruar dokumentet përkatëse dhe që procedurat e dorëzimit të jenë përmbushur nga të dyja palët.

KREU II

GJENDJA E AEROPLANIT DHE
PËRJASHTIMI NGA PËRGJEGJËSIA

Neni 8

Aeroplani, çdo motor dhe çdo pjesë përbërëse e tij (duke përfshirë, por pa u kufizuar në trupin e Aeroplanit, motorët, njësinë ndihmëse të fuqisë – APU, shasinë, komponentët, pajisjet dhe pjesët e instaluar në të, si dhe dokumentet teknike të



disponueshme dhe pajisjet, pjesët dhe të dhënat e tjera përkatëse) dhurohen dhe do t'i dorëzohen Përfituesit në gjendjen që kanë ("AS IS") dhe në vendin ku ndodhen ("WHERE IS"), në gjendje funksionale për fluturim, pa asnjë lloj deklarimi, garancie apo zotimi nga ana e Dhuruesit, të shprehur apo të nënkuptuar, pavarësisht nëse rrjedhin nga ligji apo nga ndonjë burim tjetër.

Neni 9

Përfituesi, me këtë akt, pranon në mënyrë të pakushtëzuar se Aeroplani, çdo motor dhe çdo pjesë përbërëse e tij do të dorëzohen në gjendjen që kanë ("AS IS") dhe në vendin ku ndodhen ("WHERE IS"), dhe në gjendje funksionale për fluturim në momentin e dorëzimit. Përfituesi pranon, gjithashtu, se Dhuruesi nuk jep, nuk mban dhe nuk merr përsipër asnjë kusht, term, garanci, deklarim apo zotim të çfarëdo lloji, të shprehur apo të nënkuptuar, në lidhje me gjendjen teknike për fluturim, vlerën, cilësinë, qëndrueshmërinë, gjendjen, projektimin, funksionimin, përshkrimin, tregtueshmërinë ose përshtatshmërinë për një përdorim, apo qëllim të caktuar të Aeroplanit, të çdo motori apo të çdo pjese të tij; si edhe në lidhje me mungesën e defekteve të fshehta, të brendshme apo të tjera (pavarësisht nëse mund të zbulohen apo jo), me plotësinë ose gjendjen e dokumenteve të Aeroplanit, me mungesën e shkëljes së patentave, të drejtave të autorit, dizajnit apo çdo të drejte tjetër pronësore; apo me ndonjë garanci të nënkuptuar që mund të rrjedhë nga mënyra e përdorimit, marrëdhëniet tregtare, apo praktikatat e zakonshme. Çdo kusht, garanci, deklarim, apo përgjegjësi, qoftë në kontratë apo jashtë saj (përgjegjësi jashtëkontraktore), që lidhet me ndonjë nga çështjet e mësipërme, të shprehur apo të nënkuptuar, pavarësisht nëse rrjedh nga ligji apo ndonjë burim tjetër, përjashtohet shprehimisht nga kjo Marrëveshje.

Neni 10

Përfituesi, me këtë akt, pranon se Dhuruesi, Operatori dhe Türk Hava Yolları Teknik A.Ş. (në vijim referuar si "Ofruesi i Shërbimit"), i cili ka ofruar shërbime mirëmbajtjeje për Aeroplanin që nga 20 prilli 2005 deri në datën e dorëzimit të Aeroplanit, nuk mbajnë përgjegjësi për asnjë dëm pasues, rastësor, të veçantë apo me karakter

ndëshkues (duke përfshirë humbjen e fitimit ose të të ardhurave), që lidhen në çfarëdo mënyre me këtë Marrëveshje. Përfituesi pranon, gjithashtu, se nuk ka asnjë pretendim dhe nuk do të paraqesë asnjë kërkesë ndaj Dhuruesit, Operatorit ose Ofruesit të Shërbimit, në lidhje me këto çështje, dhe heq dorë nga çdo e drejtë për të mbajtur Dhuruesin, Operatorin ose Ofruesin e Shërbimit përgjegjës në ndonjë mënyrë, pavarësisht nga natyra ose baza ligjore e pretendimit.

Neni 11

Përfituesi, në lidhje me Aeroplanin, heq dorë:

- i. nga të gjitha të drejtat e tij që lidhen me ndonjë kusht, garanci ose deklarim të shprehur ose të nënkuptuar nga Dhuruesi; dhe
- ii. nga çdo kërkesë ndaj Dhuruesit, Operatorit dhe Ofruesit të Shërbimit, pavarësisht se si dhe kur mund të lindë një kërkesë e tillë.

Neni 12

Në momentin e dorëzimit, Përfituesi merr përsipër plotësisht përgjegjësinë për përdorimin, operimin, mirëmbajtjen, riparimin dhe regjistrimin e Aeroplanit, si dhe për përputhshmërinë me rregullat dhe aktet ligjore në fuqi që lidhen me të. Me dorëzimin, Dhuruesi, Operatori dhe Ofruesi i Shërbimit nuk do të mbajnë asnjë përgjegjësi ndaj Përfituesit, apo ndonjë pale të tretë për kërkesa, humbje, dëme, kompensime, shpenzime mirëmbajtjeje ose riparimi, apo çdo shpenzim tjetër që lind

ose është i lidhur me Aeroplanin ose përdorimin e tij.

Neni 13

Përfituesi angazhohet të dëmshpërblejë, të mbrojë dhe të mbajë të padëmtuar Dhuruesin dhe institucionet, organizatat, shoqëritë e lidhura me të (duke përfshirë, për shmangie të çdo pasigurie, Türkiye Varlık Fonu, Türk Hava Yolları A.O. dhe Türk Hava Yolları Teknik A.Ş.), departamentet dhe njësitë e tjera administrative të tij, si dhe drejtorët, zyrtarët, punonjësit dhe përfaqësuesit përkatës (në vijim referuar si "Palët e mbrojtura nga përgjegjësia"), nga dhe kundrejt çdo humbjeje, përgjegjësie, kërkesë, dëmi, barre sigurie, shkaku veprimi, kompensimi, padie, gjobe, vendimi



gjyqësor, kostoje, takse, detyrimi, tarife apo shpenzimi (duke përfshirë, por pa u kufizuar në kërkesat e palëve të treta, si dhe shpenzimet e arsyeshme të avokatëve dhe të hetimit), të çdo lloji apo natyre, që shkaktohen ose lindin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga apo në çfarëdo mënyre, që lidhen me pranimin, regjistrimin, zbatimin, importin, eksportin, transportin, administrimin, shitjen, inspektimin, testimin, dorëzimin, dhënien me qira, ndryshimin, heqjen ose ridorëzimin, gjendjen, pronësinë, prodhimin, projektimin, mirëmbajtjen, shërbimin, riparimin, rishikimin, përmirësimin, modifikimin, posedimin, kontrollin, përdorimin, funksionimin, ose çdo aktivitet tjetër të Aeroplanit nga ana e Përfituesit, si dhe me çdo humbje, shkatërrim ose dëmtim të pasurisë, ose vdekje apo lëndim të ndonjë personi, të shkakuar nga, që lidhen me apo që rrjedhin (në çdo rast, drejtpërdrejt ose tërthorazi) nga ndonjë prej çështjeve të mësipërme, nga momenti i dorëzimit të Aeroplanit e në vijim.

KREU III SIGURIMI

Neni 14

Për një periudhë prej 24 (njëzet e katër) muajsh pas dorëzimit ose deri në rishikimin e madh të radhës të Aeroplanit (cilado prej këtyre që ndodh e para), Përfituesi, me shpenzimet e veta, do të mbajë në fuqi (ose do të sigurojë që çdo blerës, qiramarrës apo operator pasardhës i Aeroplanit të mbajë në fuqi) sigurimin e përgjegjësisë ligjore për Aeroplanin, i cili mbulon përgjegjësinë ndaj palëve të treta, pasagjerëve, bagazheve, ngarkesës, postës, si dhe përgjegjësinë e përgjithshme ligjore ndaj palëve të treta (duke përfshirë mbulimin për përgjegjësinë ndaj produkteve).

Ky sigurim do të përfshijë Dhuruesin dhe Palët e mbrojtura nga përgjegjësia si persona të siguruar shtesë, me një limit të vetëm të kombinuar prej jo më pak se 1.000.000.000 dollarë amerikanë (një miliard USD), dhe Përfituesi do të heqë dorë nga çdo e drejtë e subrogimit kundrejt Palëve të mbrojtura nga përgjegjësia. Përfituesi do t'i dorëzojë Dhuruesit certifikatat e sigurimit që vërtetojnë se mbulimi është në fuqi gjatë gjithë kësaj periudhe, dhe polica e sigurimit do të përmbajë dispozitat e mëposhtme:

a) Që sigurimi nuk do të anulohet dhe nuk do të

ndryshohet në mënyrë të konsiderueshme para përfundimit të një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e njoftimit të anulimit ose ndryshimit nga ana e siguresve, ose para përfundimit të një periudhe prej 7 (shtatë) ditësh në rastet që lidhen me rreziqe lufte dhe ngjarje të ndërlydhura me to.

b) Mbulimi që ofrohet nga polica e sigurimit për secilën nga Palët e mbrojtura nga përgjegjësia nuk do të shpallet i pavlefshëm, për shkak të ndonjë veprimi apo mosveprimi (përfshirë deklarime të pasakta ose fshehje informacioni) të ndonjë personi ose pale tjetër, që shkakton shkelje të ndonjë kushti, afati ose garancie të policës, me kusht që ky veprim apo mosveprim të mos jetë kryer, ndihmuar apo miratuar me dijeni nga ndonjë prej Palëve të mbrojtura nga përgjegjësia.

c) Sigurimi duhet të sigurojë mbulim në shkallë botërore.

d) Palët e mbrojtura nga përgjegjësia nuk do të kenë asnjë përgjegjësi për pagesën e primeve të sigurimit dhe siguresit heqin dorë nga çdo e drejtë për zbritje, kundërkërkesë apo kompensim ndaj ndonjëres prej Palëve të mbrojtura nga përgjegjësia.

e) Sigurimi për përgjegjësi do të përmbajë një klauzolë ndarjeje, me anë të së cilës përcaktohet se secili person i siguruar gëzon të njëjtin nivel mbrojtjeje sikur polica të ishte lëshuar individualisht për secilin, me përjashtim të kufirit maksimal të përgjegjësisë së siguresit.

f) Sigurimi për përgjegjësi do të jetë sigurim parësor, pa të drejtë kontributi apo kompensimi nga ndonjë sigurim tjetër që mund të jetë në dispozicion të Palëve të mbrojtura nga përgjegjësia.

KREU IV DEKLARIMET DHE GARANCITË

Neni 15

Përfituesi deklaron dhe garanton ndaj Dhuruesit, se:

a) ka aftësinë e plotë juridike dhe autorizimin ligjor për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe për të pranuar Aeroplanin;

b) kjo Marrëveshje është përfunduar në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme nga ana e Përfituesit dhe përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues për Përfituesin, i cili mund të zbatohet ndaj tij, në përputhje me kushtet e saj. Përfituesi ka përfunduar të gjitha procedurat e nevojshme për nënshkrimin



dhe për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, dhe ka marrë të gjitha lejet dhe miratimet e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi;

c) nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, përfundimi i transaksioneve të parashikuara prej saj, ose zbatimi i çdo kushti apo dispozite të saj nuk janë në kundërshtim me asnjë dispozitë të ligjeve në fuqi që zbatohen për këtë Marrëveshje;

d) pranon kufizimet e përcaktuara në kreun II të kësaj Marrëveshjeje.

KREU V DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 16

Kjo Marrëveshje përbën dokumentin e plotë që rregullon marrëdhëniet ndërmjet Palëve dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme, qoftë verbale apo të shkruar, që lidhet me Aeroplanin.

Neni 17

Përfituesi, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Dhuruesit, nuk mund të kalojë, transferojë apo në asnjë formë të tjetërsojë, tërësisht apo pjesërisht, këtë Marrëveshje ose të drejtat apo detyrimet që rrjedhin prej saj, te ndonjë shtet tjetër, organizatë ndërkombëtare, person juridik apo person fizik.

Neni 18

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen përmes negociatave dhe diskutimeve dypalëshe ndërmjet Përfituesit dhe Dhuruesit.

Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, Përfituesi, paraprakisht dhe pa kushte pranon të mos paraqesë padi, kërkesë për arbitrazh, apo asnjë pretendim tjetër juridik kundër Dhuruesit, Operatorit ose Ofruesit të Shërbimit, pranë ndonjë autoriteti kombëtar apo ndërkombëtar, juridiksioni ose pale të tretë.

Neni 19

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk ndikojnë mbi të drejtat dhe detyrimet e Palëve, që rrjedhin nga marrëveshje apo traktate ndërkombëtare të tjera, palë të të cilave ato janë.

KREU VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje të shkruar ndërmjet palëve, dhe çdo ndryshim i tillë përbën pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

Shtojcat (shtojca-1, shtojca-2, shtojca-3 dhe shtojca-4) janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Shtojca-3 dhe shtojca-4 do të nënshkruhen njëkohësisht me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 22

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore, të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Tiranë/Ankara, më 22.10.2025/3.11.2025, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, në gjuhën turke dhe në gjuhën angleze, të gjitha tekstet janë njëloj autentike, nga persona të autorizuar rregullisht nga Palët. Në rast mospërputhjeje ndërmjet teksteve në gjuhë të ndryshme, ose në rast divergjence interpretimi, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Pirro Vengu

Ministër i Mbrojtjes

PËR REPUBLIKËN E TURQISË

Hakkı Susmaz

Sekretar i Përgjithshëm i Presidencës



SHTOJCA-1
SPECIFIKIMET TEKNIKE TË AEROPLANIT

Të dhëna	Përmbajtja
Data e përgatitjes	27.06.2025
Lloji, modeli dhe seria e aeroplanit	A319-115J
Numri serial	1002
Regjistrimi	TC-GVC
Data e prodhimit	28.02.2000

Përshkrimi	LB	KG
Pesha maksimale për lëvizje në tokë (MTW)	167 330 lb	75 900 kg
Pesha maksimale për ngritje (MTOW)	166 448 lb	75 500 kg
Pesha maksimale pa karburant (MZFW)	128 970 lb	58 500 kg
Pesha bazë bosh (BEW)	98 744 lb	44 790 kg

INFORMACION SHITESË

- Sistemi AS400 Airshow i instaluar
- Asnjë sistem aktiv argëtimi në fluturim (IFE) i instaluar
- Asnjë sistem lidhjeje (connectivity) i instaluar
- Janë instaluar 3 njësi ACT (Additional Center Tanks)

TRUPI I AEROPLANIT

Trupi i aeroplanit	Që nga prodhimi
Orë totale fluturimi (Total Hours)	10 176
Ciklet totale (Total Cycles)	7 152

Lloji i kontrollit	C Check (inspektim i ndërmjetëm i trupit të aeroplanit)	S Check (inspektim i thelluar i trupit të aeroplanit)
Kodi dhe data e kontrollit të fundit	C011 — 15.03.2024 (10 171 FH, 7 138 FC)	S003 — 30.03.2023 (10 081:43 FH, 7 073 FC)
Data ose orët e planifikuara për kontrollin e ardhshëm	15.03.2026	29.03.2029
Intervali i kontrollit	7 500 FH / 24 Muaj	6 vite



Përshkrimi	Pajisja e përparme e uljes (Nose)	Kryesore (majtas)	Kryesore (djathtas)
Prodhuesi	MESSIER-DOWTY	MESSIER-DOWTY	MESSIER-DOWTY
Numri i pjesës	D23589510-107	201581001	201581002
Numri serial	B374	MDL-1002	MDL-1002
TSN (numri total i orëve të përdorimit që nga prodhimi)	10 058	10 058	10 058
CSN (numri total i cikleve ngritje-ulje që nga prodhimi)	7 071	7 071	7 071
CBO (numri total i cikleve ngritje-ulje që nga prodhimi)	450	450	450
TBO (numri i orëve të mbetura përpara rishikimit të përgjithshëm)	711	711	711
Data e ardhshme e rishikimit të përgjithshëm	27 Korrik 2029	27 Korrik 2029	27 Korrik 2029

Përshkrimi	APU	Motori majtas	Motori djathtas
Marka dhe modeli	APS3200	CFM56-5B7/P	CFM56-5B7/P
Numri serial	2136	779669	779670
Koha që nga prodhimi	24 461	10 176:5	10 176:5
Ciklet që nga prodhimi	29 514	7 152	7 152



SHTOJCA-2

CERTIFIKATË DORËZIMI/PRANIMI

Në lidhje me një (1) aeroplan Airbus model A319-115J, me numër serial prodhuesi 1002, dhe me dy (2) motorë të bashkëngjitur të tipit CFM56-5B7/P, me numra serialë prodhuesi 779669 dhe 779670 (në vijim referuar si “Aeroplani”);

Në bazë të “Marrëveshjes së Dhurimit ndërmjet Republikës së Turqisë dhe Republikës së Shqipërisë” (“Marrëveshja”), të nënshkruar më/...../2025, (termet e shkruara me shkronjë të madhe që nuk janë përcaktuar veçmas këtu do të kenë kuptimin përkatës që u jepet në Marrëveshje),

Kjo certifikatë vërteton se:

Republika e Shqipërisë (“Përfituesi”) ka inspektuar aeroplanin dhe deklaroi se është plotësisht e kënaqur me gjendjen teknike të tij;

Se Përfituesi ka pranuar dorëzimin e aeroplanit, i cili ndodhet në

..... në orën lokale

.....;

Dhe se Përfituesi ka marrë në dorëzim aeroplanin në gjendjen që ndodhet (“AS IS”) dhe në vendin ku ndodhet (“WHERE IS”), në gjendje të vlefshme për fluturim, duke pranuar që Republika e Turqisë (“Dhuresi”) nuk jep asnjë deklaram apo garanci në lidhje me gjendjen e aeroplanit.

Kjo Certifikatë Dorëzimi/Pranimi dhe çdo detyrim që lind prej saj ose në lidhje me të, do të zbatohen dhe interpretohen në përputhje me Marrëveshjen.

1 – Nga personi i autorizuar, në emër dhe për llogari të Përfituesit

Nënshkrimi:

Emri:

Detyra:

Data:

2 – Nga personi i autorizuar, në emër dhe për llogari të Dhuresit

Nënshkrimi:

Emri:

Detyra:

Data:



SHTOJCA-3

DEKLARATË PËR PËRPUTHSHMËRINË ME SANKSIONET

Kjo Deklaratë për Përputhshmëri me Sanksionet ("Deklarata") nënshkruhet ndërmjet Republikës së Turqisë ("Dhuruesi") dhe Republikës së Shqipërisë ("Përfituesi"). Duke nënshkruar këtë Deklaratë, Përfituesi deklaron, garanton dhe angazhohet se:

1.

Përfituesi, në çdo kohë, do të respektojë plotësisht të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi që zbatohen për çdo veprimtari apo transaksion që lidhet me aeroplanin A319-115J, me shenjë e regjistrimit TC-GVC dhe numrin serial 1002 ("Aeroplani").

2.

Përfituesi nuk do të përfshihet dhe nuk do të marrë pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në asnjë akt, transaksion apo veprimtari që lidhet me Aeroplanin dhe që bie ndesh ose është në kundërshtim me legjislacionin për parandalimin e ryshfetit dhe korrupsionit, ligjet kundër pastrimit të parave, ligjet kundër financimit të terrorizmit, rregulloret për sanksionet ose kontrollet e eksportit, si dhe legjislacionin për ndalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe skllavërisë, apo ndonjë ligj penal ose rregullator të ndonjë qeverie apo autoriteti, përfshirë, por pa u kufizuar:

- (i) Republikës së Turqisë,
- (ii) Shteteve të Bashkuara të Amerikës,
- (iii) Bashkimit Evropian, dhe
- (iv) Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

3.

Përfituesi nuk do të ndërmarrë dhe nuk do të lejojë asnjë akt, transaksion apo veprimtari që mund të çojë në përfshirjen e Aeroplanit si objekt apo subjekt i sanksioneve, kontrolleve të eksportit, ngrirjes së aseteve apo masave të tjera kufizuese, të vendosura ose të mbajtura në fuqi nga:

- (i) Republika e Turqisë,
- (ii) Shtetet e Bashkuara të Amerikës,
- (iii) Bashkimi Evropian, dhe
- (iv) Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Në emër të Republikës së Shqipërisë

Nënshkrimi:

Emri: Pirro VENGU

Detyra: Ministër i Mbrojtjes

Data: 22/08/2022





SHTOJCA-4

**DEKLARATË E PËRPUTHSHMËRISË PËR PËRDORIMIN DHE
PËRDORUESIN PËRFUNDIMTAR**

Është politikë e Republikës së Turqisë ("Dhuruesi") që, kur është e nevojshme, të verifikojë përdorimin dhe përdoruesin përfundimtar të produkteve, pajisjeve, programeve kompjuterike dhe teknologjive, me qëllim të sigurimit të përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret për kontrollin e eksporteve, embargot dhe/ose sanksionet ("Sanksionet dhe Kontrolli i Eksporteve") të:

- (i) Republikës së Turqisë,
- (ii) Shteteve të Bashkuara të Amerikës,
- (iii) Bashkimit Evropian, dhe
- (iv) Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Meqenëse aeroplani A319-115J, me shenjë regjistrimi TC-GVC dhe numër serial prodhuesi 1002 ("Aeroplani"), i pranuar nga Republika e Shqipërisë ("Përfituesi"), mund të përdoret jashtë juridiksionit të vendeve dhe bashkësive të përmendura më sipër, kërkohet konfirmimi i mëposhtëm:

- Përfituesi pranon që nuk do të përdorë, shesë, rishesë, japë me qira, eksportojë, riekportojë, devijojë apo transferojë në çfarëdo forme Aeroplanin, te asnjë person, subjekt apo shtet që i nënshtrohet Sanksioneve dhe Kontrollit të Eksporteve, përfshirë ata që janë të listuar në regjistrat e subjekteve të ndaluara ose të kufizuara.
- Përfituesi pranon që nuk do të përdorë, shesë, rishesë, japë me qira, eksportojë, riekportojë, devijojë, dorëzojë apo transferojë në çfarëdo forme, drejtpërdrejt ose tërthorazi, Aeroplanin në kundërshtim me apo duke shmangur Sanksionet dhe Kontrollin e Eksporteve, si dhe për ndonjë qëllim të ndaluar sipas tyre.
- Përfituesi pranon që nuk do ta përdorë, shesë, rishesë, japë me qira, eksportojë, riekportojë, devijojë, dorëzojë apo transferojë në çfarëdo forme Aeroplanin për përdorim në aktivitetet që lidhen me zhvillimin, prodhimin, përdorimin apo grumbullimin e pajisjeve bërthamore shpërthyesë, armëve kimike ose biologjike, raketave, mjeteve ajrore pa pilot (UAV), ose mikroprocesorëve për përdorim ushtarak, të ndaluara në bazë të Sanksioneve dhe Kontrollit të Eksporteve.

Në emër të Republikës së Shqipërisë

Nënshkrimi:

Emri: Pirro VENGU

Detyra: Ministër i Mbrojtjes

Data: 22/12/2025



**URDHËR****Nr. 147, datë 31.10.2025****PËR DELEGIMIN DHE DISA
RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR
TË MINISTRISË SË TURIZMIT,
KULTURËS DHE SPORTIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11 dhe pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS), Sekretarit të Përgjithshëm, si vijon:

a) autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit në proceset gjyqësore, kur ajo thirret si palë në gjykim, nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit/personave që do të përfaqësojnë ministrinë;

b) nënshkrimi i akteve procedurale, si: kërkesëpadi, prapësime, deklarata mbrojtjeje, parashtrime, ankime, rekurse etj., bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Përgjashtimisht, paraqitja e kërkesave të tjera, si dhe çdo veprim procedural i nevojshëm gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, mund të bëhet edhe nga përfaqësuesit me autorizim, me shkrim dhe/ose me gojë.

2. Përfaqësimi në proceset gjyqësore kryhet, si rregull, nga juristë të Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore pranë MTKS-së. Në rast se vlerësohet e rëndësishme, struktura përgjegjëse për përfaqësimin ligjor i kërkon edhe drejtorive teknike caktimin e një nëpunësi për përfaqësimin e përbashkët të çështjes në gjykatë. Rast pas rasti, përfaqësimi gjyqësor mund të kryhet edhe nga nëpunës të institucioneve të varësisë dhe/ose degët e tyre territoriale, pas përcjelljes së autorizimit nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

3. Kur institucionet në varësi të MTKS-së, përfshihen në procedura gjyqësore/përmbarrimore

dhe nuk kanë në strukturat e tyre juristë, detyrohen të njoftojnë, brenda 1 (një) dite pune nga akti i njoftimit të gjykatës/shërbimit përmbarrimor, në rrugë elektronike dhe shkresore, Sektorin e Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore pranë MTKS-së, me qëllim hartimin e akteve të mbrojtjes ligjore. Në çdo rast, titullarët e këtyre institucioneve sigurojnë koordinimin me sektorin e lartpërmendur dhe ndjekjen e afateve ligjore, në kushtet kur aktet procedurale të mbrojtjes ligjore nënshkruhen dhe protokollohen po nga këto institucione.

4. Të gjitha strukturat e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, si dhe institucionet në varësi të saj, detyrohen të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm, mbajtjen e një qëndrimi zyrtar me shkrim dhe/ose dhënie mendimi teknik, me qëllim realizimin e mbrojtjes ligjore nga ana e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore.

5. Drejtoria e Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme merr masa për sigurimin e logistikës së nevojshme dhe lëshimin e autorizimeve përkatëse ndaj juristëve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në varësi të seancave gjyqësore të caktuara dhe rëndësisë që paraqet procesi gjyqësor.

6. Delegimi i kompetencave fillon me hyrjen në fuqi të këtij urdhri dhe mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit dhe/ose me pushimin e organit delegues ose të deleguar.

7. Kompetencat e deleguara në pikën 1 të këtij urdhri, nuk shoqërohen me efekte financiare.

8. Urdhri nr. 889, datë 29.10.2024, “Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, i ndryshuar, për pjesën e fushës së përgjegjësisë shtetërore të kulturës, shfuqizohet.

9. Ngarkohen të gjitha strukturat e aparatit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, si dhe institucionet në varësi të saj, për zbatimin e këtij urdhri.

10. Ngarkohet Sektori i Arkiv/Protokollit për komunikimin e këtij urdhri strukturave përkatëse të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, si dhe institucioneve në varësi të saj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja**

**URDHËR****Nr. 148, datë 31.10.2025****PËR RAPORTIMIN E TË DHËNAVE
DHE ECURISË SË ÇËSHTJEVE
GYJQËSORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjesisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS)”,

URDHËROJ:

1. Juristët e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore pranë MTKS-së, si dhe nëpunësit përgjegjës për përfaqësimin ligjor në institucionet e varësisë dhe/ose degët e tyre territoriale, raportojnë të dhënat për çështjet gjyqësore që kanë në ndjekje, duke pasqyruar nëpërmjet një format tabelle:

- a) numrin e çështjes në regjistrin elektronik të ministrisë/institucionit të varësisë;
- b) numrin e aktit;
- c) palët ndërgjyqëse;
- d) objektin e çështjes;
- e) gjykatën dhe gjyqtarin/gjyqtarët aktual të çështjes;
- f) ecurinë e gjykimit dhe zhvillimet gjatë seancave përgatitore/gjyqësore;
- g) planifikimin e gjykimit dhe fazën procedurale pasardhëse;
- h) rezultatin e çështjes (dispozitivi i vendimit, numri dhe data e vendimit);
- i) klasifikimin e çështjes sipas kodit “A”;
- j) problematika të evidentuara gjatë gjykimit;
- k) dëmin e parandaluar apo të shkaktuar (në vlerë dhe në sipërfaqe m²);
- l) datën e ankimit/rekursit;
- m) informacionin e shkurtuar të rezultatit të çështjes (fituar, humbur, fituar pjesërisht, jashtë juridiksioni, jashtë kompetence, pushuar, pezulluar, kthim aktesh, rigjykim, deleguar, relatuar).

2. Raportimi kryhet sipas tabelës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij urdhri, dhe informacioni i

shkurtuar pasqyrohet sipas përcaktimit në shkronjën “m”, të pikës 1 të këtij urdhri.

3. Në çështjet gjyqësore në të cilat kërkohet “marrja e masës së sigurimit të padisë” apo “sigurimi i provës”, të cilat kanë afate të shkurtra kohore, raportohet menjëherë me marrjen në dijeni të tyre pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MTKS-së dhe personit të kontaktit të caktuar për koordinimin e mbrojtjes me Avokaturën e Shtetit.

4. Tabela bashkëlidhur këtij urdhri do të përmbajë informacionin për të gjitha çështjet gjyqësore të ndjekura brenda një viti pune dhe do të përsëritet në fillim të çdo viti, duke pasqyruar çështjet e mbartura, të ankimuara dhe çështjet e reja. Numri rendor i çështjeve në tabelën raportuese duhet të mbetet i njëjtë deri në fund të vitit.

5. Juristët e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore, si dhe nëpunësit përgjegjës për përfaqësimin ligjor në institucionet e varësisë dhe/ose degët e tyre territoriale, dërgojnë në adresat zyrtare elektronike të Sekretarit të Përgjithshëm të MTKS-së dhe personit të kontaktit tabelën e raportimit çdo ditë të premte të javës, duke përditësuar ecurinë gjatë javës dhe planifikimin për javën pasardhëse. Në rastet kur e premja është ditë feste zyrtare, raportimi duhet të kryhet ditën pararendëse.

6. Brenda datës 5 (pesë) të çdo muaji, juristët e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore, si dhe nëpunësit përgjegjës për përfaqësimin ligjor në institucionet e varësisë dhe/ose degët e tyre territoriale, dërgojnë në adresat zyrtare elektronike të Sekretarit të Përgjithshëm të MTKS-së dhe personit të kontaktit, raportim të detajuar mbi ecurinë e të gjitha çështjeve të mbartura, në proces dhe të përfunduara gjatë muajit, dhe planifikimin për secilën çështje.

7. Ngarkohen të gjitha strukturat e aparatit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, dhe institucionet në varësi të saj, për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Sektori i Arkiv/Protokollit për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

**URDHËR****Nr. 578, datë 11.11.2025****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE
DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT TË ARSIMIT,
ZNJ. ORJANA OSMANI**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit, zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani, për ushtrimin e kompetencave në fushën e arsimit parauniversitar, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) ndjek dhe nënshkruan të gjitha aktet për zbatimin e programit të qeverisë lidhur me hartimin, zbatimin dhe monitorimin strategjive kombëtare në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe planeve të veprimit në zbatim të tyre, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

b) kontribuon në hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për organizimin dhe veprimtarinë në fushën e arsimit parauniversitar, për çështjet kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

c) inicion dhe ndjek përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore bazuar në planin e miratuar të akteve dhe rregulloreve për veprimtaritë kurrikulare, që kryhen brenda orarit mësimor;

ç) trajton, nënshkruan dhe monitoron zbatimin e standardeve dhe kritereve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, në fushën e arsimit parauniversitar për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

d) drejton dhe koordinon me institucionet përgjegjëse realizimin dhe monitorimin e Maturës Shtetërore dhe trajton e nënshkruan të gjitha aktet për realizimin e saj në përputhje me legjislacionin dhe politikat e Ministrisë përgjegjëse për arsimin;

dh) siguron të dhëna të detajuara dhe analiza periodike për politikat e zhvillimit të arsimit parauniversitar, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

e) ndjek dhe monitoron zbatimin e planit të veprimit për organizimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe në ushtrimin e detyrave të tyre profesionale, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

ë) nënshkruan, ndjek dhe monitoron ecurinë e programeve të financimit të arsimit parauniversitar, investimeve në arsimin parauniversitar, përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin e arsimit parauniversitar, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

f) nënshkruan dhe drejton grupe pune me nëpunës të ministrisë përgjegjëse për arsimin, apo të strukturave vartëse për hartimin e akteve ligjore, nënligjore në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe ndjek procesin për realizimin e detyrave të tyre, për veprimtaritë kurrikulare, që kryhen brenda orarit mësimor;

g) nënshkruan, ndjek dhe monitoron zbatimin e programeve dhe projekteve në fushën e arsimit parauniversitar, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

gj) ndjek dhe monitoron programet dhe planet e veprimit të Strategjisë Kombëtare të Arsimit dhe planet e veprimit në zbatim të legjislacionit në fuqi, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

h) ndjek, monitoron dhe nënshkruan akte që lidhen me performancën e strukturave arsimore të varësisë, duke marrë masa për organizimin e punës me strukturat përgjegjëse që kanë fokus dhe objekt të punës arsimin parauniversitar, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

i) ndjek, monitoron dhe nënshkruan akte që lidhen me projektet strategjike dhe programet arsimore duke bashkërenduar punën me ministrinë e linjës dhe institucionet partnere ndërkombëtare, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

j) nënshkruan ngritjen e grupeve të punës dhe i drejton ato, në funksion të analizimit të programeve



e projekteve dhe inicion përmirësimit të tyre në bashkëpunim me partnerë dhe ekspertë vendës dhe të huaj, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

k) nënshkruan dhe miraton rregulloret tip të institucioneve të varësisë dhe manualët operacionale tip, për punën e institucioneve të arsimit parauniversitar, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

l) trajton dhe nënshkruan shkresat që i drejtohen institucioneve paralele për çështje të antikorrupsionit dhe bashkëqeverisjes, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

ll) ndjek dhe nënshkruan kthimin e përgjigjeve për shkresat, kërkesat dhe ankesat e ardhura nga institucionet shtetërore dhe organizmat e tjerë për fushën e arsimit parauniversitar, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

m) ndjek dhe nënshkruan udhëzimet në fushën e arsimit parauniversitar, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

n) nënshkruan dhe trajton dhënien e lejeve dhe licencave në fushën e arsimit parauniversitar, apo miratimin e drejtuesve didaktik dhe kritereve të tjera të licencimit arsimin parauniversitar;

nj) përfaqëson ministrinë në këshilla vendës apo të huaj, grupe punë ndërinstitucionale, komisione sipas delegimit përkatës për fushën e përgjegjësisë që mbulon apo evente të tjera, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

o) përfaqëson institucionin në grupe pune, lidhur me fushën e arsimit, me qëllim hartimin dhe ndjekjen e programeve, projekteve dhe politikave arsimore në vend, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

p) bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrin për çështjet e arsimit të lartë, për çështje të caktuara që i përkasin edhe fushës së përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendësministrave, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

q) ndjek procedurat e ngarkuara apo të autorizuar nga Ministri, bazuar në legjislacionin në fuqi, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

r) trajton dhe nënshkruan përgjigjet për kontrollet dhe raportet e auditit të brendshëm sipas fushës së përgjegjësisë, të koordinuara nga Sekretari i Përgjithshëm, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor;

rr) informon periodikisht dhe sa herë është e nevojshme, ndjekjen e detyrave dhe zbatimin e tyre, pranë Kabinetit të Ministrit, për veprimtaritë kurrikulare që kryhen brenda orarit mësimor.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të lehtësoje dhe mbështesë zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegates ose të deleguar.

5. Urdhri nr. 497, datë 29.9.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri zëvendësministri i Arsimit, znj. Orjana Osmani dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR
Nr. 579, datë 11.11.2025

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE
DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT TË ARSIMIT,
ZNJ. HERIDA DURO**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit, zëvendësministrit të Arsimit, znj. Herida Duro, për ushtrimin e kompetencave në fushën e arsimit parauniversitar, lidhur me veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor.



2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) ndjek dhe nënshkruan të gjitha aktet për zbatimin e programit të qeverisë lidhur me hartimin, zbatimin dhe monitorimin strategjive kombëtare në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe planeve të veprimit në zbatim të tyre për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

b) kontribuon në hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për organizimin dhe veprimtarinë në fushën e arsimit parauniversitar, për çështjet ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

c) inicicion dhe ndjek përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore bazuar në planin e miratuar të akteve dhe rregulloreve, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

ç) trajton, nënshkruan dhe monitoron zbatimin e standardeve dhe kritereve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, në fushën e arsimit parauniversitar, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

d) siguron të dhëna të detajuara dhe analiza periodike për politikën e zhvillimit të arsimit parauniversitar, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

dh) ndjek dhe monitoron zbatimin e planit të veprimit për organizimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe në ushtrimin e detyrave të tyre profesionale, për veprimtaritë ekstrakurrikulare, që kryhen jashtë orarit mësimor;

e) nënshkruan, ndjek dhe monitoron ecurinë e programeve të financimit të arsimit parauniversitar, investimeve në arsimin parauniversitar, përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin e arsimit parauniversitar, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

ë) nënshkruan dhe drejton grupe pune me nëpunës të ministrisë përgjegjëse për arsimin apo të strukturave vartëse për hartimin e akteve ligjore, nënligjore në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe ndjek procesin për realizimin e detyrave të tyre, lidhur me veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

f) nënshkruan, ndjek dhe monitoron zbatimin e programeve dhe projekteve në fushën e arsimit parauniversitar, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

g) ndjek dhe monitoron programet dhe planet e veprimit të Strategjisë Kombëtare të Arsimit dhe planet e veprimit në zbatim të legjislacionit në fuqi, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

gj) ndjek, monitoron dhe nënshkruan akte që lidhen me performancën e strukturave arsimore të varësisë, duke marrë masa për organizimin e punës me strukturat përgjegjëse, që kanë fokus dhe objekt të punës arsimin parauniversitar, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

h) ndjek, monitoron dhe nënshkruan akte që lidhen me projektet strategjike dhe programet arsimore duke bashkërenduar punën me ministrinë e linjës dhe institucionet partnere ndërkombëtare, lidhur me veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

i) nënshkruan ngritjen e grupeve të punës dhe i drejton ato, në funksion të analizimit të programeve e projekteve dhe inicicion përmirësimin e tyre në bashkëpunim me partnerë dhe ekspertë vendës dhe të huaj, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

j) nënshkruan dhe miraton rregulloret tip të institucioneve të varësisë dhe manualët operacionale tip, për punën e institucioneve të arsimit parauniversitar, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

k) trajton dhe nënshkruan shkresat që i drejtohen institucioneve paralele për çështje të antikorrupsionit dhe bashkëqeverisjes, lidhur me veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

l) ndjek dhe nënshkruan kthimin e përgjigjeve për shkresat, kërkesat dhe ankesat e ardhura nga institucionet shtetërore dhe organizmat e tjerë për fushën e arsimit parauniversitar, lidhur me veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

ll) ndjek dhe nënshkruan udhëzimet në fushën e arsimit parauniversitar, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

m) përfaqëson ministrinë në këshilla vendës apo të huaj, grupe pune ndërinstitucionale, komisione sipas delegimit përkatës për fushën e përgjegjësisë që mbulon apo evente të tjera, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

n) përfaqëson institucionin në grupe pune, lidhur me fushën e arsimit, me qëllim hartimin dhe ndjekjen e programeve, projekteve dhe politikave



arsimore në vend, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

nj) bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrin për çështjet e arsimit të lartë, për çështje të caktuara që i përkasin edhe fushës së përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendësministrave, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

o) ndjek procedurat e ngarkuara apo të autorizuar nga Ministri, bazuar në legjislacionin në fuqi, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

p) trajton dhe nënshkruan përgjigjet për kontrollet dhe raportet e auditit të brendshëm sipas fushës së përgjegjësisë, të koordinuara nga Sekretari i Përgjithshëm, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor;

q) informon periodikisht dhe sa herë është e nevojshme, ndjekjen e detyrave dhe zbatimin e tyre, pranë Kabinetit të Ministrit, për veprimtaritë ekstrakurrikulare që kryhen jashtë orarit mësimor.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të lehtësojë dhe mbështesë zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri zëvendësministri i Arsimit, znj. Herida Duro dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR
Nr. 580, datë 11.11.2025

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE
DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT TË ARSIMIT,
ZNJ. ARMELA BAKA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të

Ministrave”; dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit, zëvendësministrit të Arsimit, znj. Armela Baka, për ushtrimin e kompetencave në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) Ndjek dhe nënshkruan akte për zbatimin e programit të qeverisë lidhur me hartimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjive kombëtare në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe planeve të veprimit në zbatim të tyre;

b) Kontribuon në hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, për organizimin dhe veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

c) Inicion dhe ndjek përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore bazuar në planin e miratuar të akteve dhe rregulloreve;

ç) Monitoron dhe organizon punën për zbatimin e strategjive kombëtare për arsimin në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, dhe nënshkruan akte që lidhen me to përfshirë programet dhe planet e veprimit të Strategjisë Kombëtare të Arsimit dhe Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe planet e veprimit të tyre, në zbatim të legjislacionit në fuqi;

d) Trajton dhe miraton standarde dhe kritere të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe monitoron zbatimin e tyre;

dh) Siguron të dhëna të detajuara dhe analiza periodike për politikat e zhvillimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

e) Ndjek dhe monitoron zbatimin e planit të veprimit për organizimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe në ushtrimin e detyrave të tyre profesionale;

ë) Trajton dhe nënshkruan programet e financimit dhe investimeve në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, përfshirë edhe ato që



lidhen me digjitalizimin, si dhe ndjek dhe monitoron ecurinë e zbatimit të tyre;

f) Nënshkruan dhe drejton grupe pune me nëpunës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin apo të strukturave vartëse për hartimin e akteve ligjore, nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe ndjek procesin për realizimin e detyrave të tyre;

g) Trajton dhe nënshkruan aktet për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të institucioneve të arsimit të lartë për të gjitha ciklet e studimit, ofrimin e programeve të studimit edhe në gjuhë të huaj, certifikimin e kapaciteteve pritëse dhe rialokimin e kuotave të miratuara brenda njësite kryesore;

gj) Trajton dhe miraton projekt-statutet dhe ndryshimet statutores të institucioneve të arsimit të lartë;

h) Nënshkruan, ndjek dhe monitoron zbatimin e programeve dhe projekteve në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

i) Ndjek dhe monitoron performancën e strukturave arsimore të varësisë, duke marrë masa për organizimin e punës me strukturat përgjegjëse, me fokus strukturat AKFAL, AKKSHI, QSHA, ASCAL dhe institucionet e tjera që kanë fokus dhe objekt të punës arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor;

j) Nënshkruan, ndjek dhe monitoron projektet strategjike dhe programet e studimit të të gjitha cikleve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, duke bashkërenduar punën me ministrinë e tjera dhe të gjitha institucionet partnere kombëtare dhe ndërkombëtare;

k) Drejton grupe pune, në funksion të analizimit të programeve e projekteve dhe inicion përmirësimit të tyre në bashkëpunim me partnerë dhe ekspertë vendas dhe të huaj;

l) Nënshkruan dhe miraton rregulloret tip të institucioneve të varësisë dhe manualet operacionale tip, për punën e institucioneve të varësisë në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

ll) Trajton dhe nënshkruan shkresat që i drejtohen institucioneve të tjera për çështje të antikorrupsionit dhe bashkëqeverisjes, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

m) Ndjek monitoron dhe nënshkruan, projekt-raportet dhe raportet e kontrollit të ligjshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë;

n) Trajton dhe monitoron kthimin e përgjigjeve për shkresat, kërkesat dhe ankesat e ardhura nga institucionet shtetërore dhe organizmat e tjerë për fushën e arsimit të lartë;

nj) Trajton dhe nënshkruan miratimin e vendimit të arsyetuar për vlerësimin e kontributit të shtetasve të huaj që kërkojnë fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e arsimit të lartë ose shkencës, nëse ai përbën interes për shtetin shqiptar ose jo, sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi, si dhe dhënien e pëlqimit nga ministria përgjegjëse për arsimin për titullin *“Doctor Honoris Causa”*, sipas kërkesave të institucioneve të arsimit të lartë, pas procedurave të verifikimit;

o) Përfaqëson ministrinë në këshilla vendas apo të huaj, grupe pune ndërinstitucionale, komisione sipas delegimit përkatës për fushën e përgjegjësisë që mbulon apo evente të tjera;

p) Përfaqëson institucionin në grupe pune lidhur me fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, me qëllim hartimin dhe ndjekjen e programeve, projekteve dhe politikave arsimore në vend;

q) Bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrin për çështjet e arsimit parauniversitar, për çështje të caktuara që i përkasin edhe fushës së përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendësministrave;

r) Informon periodikisht dhe sa herë është e nevojshme, ndjekjen e detyrave dhe zbatimin e tyre, pranë Kabinetit të ministrit;

rr) Ndjek procedurat ngarkuara ose autorizuar nga ministri bazuar në legjislacionin në fuqi;

s) Ndjek dhe nënshkruan njohjen dhe njësimin e titujve akademikë dhe gradave shkencore të fituara jashtë vendit, duke përfshirë kryesimin dhe ngritjen e Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNJG) dhe komisioneve *ad-hoc* për njohjen e titujve akademikë për secilin aplikim, për njohje titulli akademik të fituar jashtë vendit, me pedagogë ekspertë të fushës përkatëse të kategorisë “Profesor”;

sh) Kryeson Bordin e Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

t) trajton dhe nënshkruan përgjigjet për kontrollet dhe raportet e auditit të brendshëm sipas fushës së përgjegjësisë, të koordinuara nga Sekretari i Përgjithshëm, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

th) Ndjek dhe nënshkruan udhëzimet në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.



3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të lehtësoje dhe mbështesë zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegates ose të deleguar.

5. Urdhri nr. 496, datë 29.9.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Ana Kapaj”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri zëvendësministri i Arsimit, znj. Armela Baka dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR
Nr. 1139, datë 6.11.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E IRLANDËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Irlandës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Carlow*	-	-

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



URDHËR

Nr. 1140, datë 6.11.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E FRANCËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
Hauts-de-France	Pas-de-Calais	Calais*
Pays de la Loire	Loire-Atlantique	Châteaubriant*
Pays de la Loire	Vendée	Fontenay-le-Comte*
Nouvelle-Aquitaine	Lot-et-Garonne	Nérac*
Grand Est	Haute-Marne	Saint-Dizier*
Centre-Val de Loire	Cher	Bourges*
Auvergne-Rhône-Alpes	Allier	Moulins*
Bourgogne-Franche-Comté	Côte-d'Or	Beaune*
Grand Est	Marne	Vitry-le-François*
Pays de la Loire	Vendée	Les Sables-d'Olonne*
Pays de la Loire	Vendée	La Roche-sur-Yon*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1127, datë 4.11.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



URDHËR

Nr. 1141, datë 6.11.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të Ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- e) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Neuhardenberg*
Bayern	Dingolfing-Landau	Simbach*
Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Triebes*
Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*
Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel*
Niedersachsen	Diepholz	Stuhr*
Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Beetzsee*
Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritze*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torgelow-Ferdinandshof*

Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
Brandenburg	Oberhavel	Kremmen*
Baden-Württemberg	Alb-Donau-Kreis	Langenau*
Niedersachsen	Cloppenburg	Bösel*
Nordrhein-Westfalen	Kleve	Rees*
Niedersachsen	Vechta	Vechta*
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
Brandenburg	Prignitz	Plattenburg*
Niedersachsen	Diepholz	Barnstorf*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Föhr-Amrum*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Sylt*
Niedersachsen	Emsland	Geeste*
Niedersachsen	Stade	Fredenbeck*
Niedersachsen	Harburg	Tostedt*
Niedersachsen	Oldenburg	Ganderkesee*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Peenetal/Loitz*
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Letschin*
Niedersachsen	Cloppenburg	Friesoythe*
Brandenburg	Uckermark	Lychen*
Nordrhein-Westfalen	Wesel	Kamp-Lintfort*
Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Selsingen*
Niedersachsen	Vechta	Goldenstedt*
Thüringen	Nordhausen	Ellrich*
Sachsen-Anhalt	Mansfeld-Südharz	Goldene Aue*
Niedersachsen	Emsland	Lengerich*
Niedersachsen	Rotenburg (Wümme)	Bremervörde*
Niedersachsen	Stade	Oldendorf-Himmelpforten*
Niedersachsen	Oldenburg	Harpstedt*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve



për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1130, datë 4.11.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1142, datë 6.11.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HOLANDËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- e) vezëve të shpendëve;
- f) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
Drenthe	Aa en Hunze*
Gelderland	Kesteren*
Gelderland	Hummelo en Keppel*
Flevoland	Noordoostpolder*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1099, datë 30.10.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1143, datë 6.11.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- e) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- f) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Susz*
Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Reszel*
Wielkopolskie	Ostrzeszów	Mikstat*
Wielkopolskie	Turek	Kawęczyn*
Wielkopolskie	Turek	Przykona*
Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Grunwald*
Wielkopolskie	Konin	Rzgów*

Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Pozezdrze*
Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)*
Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Zalewo*
Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
Wielkopolskie	Środa	Środa
Wielkopolskie	Wielkopolska	Wielkopolska*
Lubuskie	Międzyrzecz	Skwierzyna*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1124, datë 4.11.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



NJOFTIM

Nr. 16144, datë 10.11.2025

MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

“Marrëveshja për qasjen në arsimin e lartë dhe pranimin për të studiuar në Ballkanin Perëndimor”, nënshkruar në Berlin, më 14.10.2024, ka hyrë në fuqi për palën shqiptare më 18 shtator 2025.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM

Nr. 50, datë 25.9.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 25.9.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 24 (K) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Kostandin Xholli, i përfaqësuar nga avokat Altin Ibro, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Agjencia e Trajtimit të Pronave, Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 10-2015-1185(523), datë 19.5.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2024-1183, datë 19.3.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në gjykatën kompetente të apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 71 e

vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); neni 460 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit Kostandin Xholli (*kërkuari*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë së Trajtimit të Pronave (*ATP*), Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari është një nga trashëgimtarët ligjorë të shtetasit J.Xh. (i biri), për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2682, datë 22.10.1996, ka vendosur vërtetimin e faktit juridik të pronësisë përpara reformës agrare për një sipërfaqe toke prej 39.2 dynmësh, të ndodhur në fshatin Gjinar, Elbasan, sipas parcelave dhe kufizimeve përkatëse, por pa përcaktuar vendndodhjen e këtyre pronave në hartat treguese të pasurive. Po kështu, me vendimin nr. 1720, datë 22.11.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur vërtetimin e faktit juridik të pronësisë të ish-pronarit J.Xh. edhe për disa pasuri të paluajtshme të ndodhura në fshatin Gjinar, Elbasan, duke përcaktuar vendndodhjen e tyre, e pasqyruar kjo në hartat e përgatitura nga eksperti i thirrur në gjykim.

2. Kërkuari, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor, në datën 27.9.1996, në bazë të ligjit nr. 7698/1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” (*ligji nr. 7698/1993*) i është drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Rrethit Elbasan me kërkesë për njohjen dhe kthimin e kompensimin e pronave të ish-pronarit J.Xh. Duke qenë se kërkuari nuk ka paraqitur hartat për përcaktimin e vendndodhjes së pronave, kërkesa nuk është marrë në shqyrtim.

3. Me shkresën nr. 710, datë 6.6.2008 të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*ZRKKP*), qarku Elbasan, është bërë shpallja publike për njoftimin e të gjitha subjekteve që kishin paraqitur kërkesa në ish-KKKP të cilat nuk ishin



shqyrtuar ende, duhet të paraqisnin dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit nr. 9235/2004 dhe akteve të dala në zbatim të tij. Duke qenë se kërkuksi nuk ka paraqitur dokumente të tjera veç atyre të paraqitura deri në daljen e shpalljes, me vendimin nr. 526, datë 4.9.2008, ZRKKP-ja, Elbasan ka vendosur mosnjohjen e së drejtës së pronësisë të subjektit kërkuks, përfaqësues i subjektit të shpronësuar J.Xh.

4. Kundër këtij vendimi kërkuksi ka paraqitur ankim në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*sot ATP*), Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 1168, datë 20.11.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të ZRKKP-së, Elbasan, me arsyetimin se kërkuksi nuk ka arritur të provojë me dokumentacionin e duhur ligjor të drejtën e pronësisë të ish-pronarit mbi pasuritë e pretenduara. Duke mos qenë dakord me këto vendime administrative, kërkuksi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt kundërshtimin e vendimeve të ZRKKP-së, Elbasan dhe të ish-AKKP-së, Tiranë.

5. Me vendimin nr. 1004, datë 27.4.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur të pranojë padinë e kërkuksit, duke anuluar vendimet e ZRKKP-së, Elbasan dhe të ish-AKKP-së, Tiranë dhe ka njohur të drejtën e pronësisë të ish-pronarit J.Xh. (trashëgimtarëve të tij) mbi një sipërfaqe toke bujqësore pyll, kullotë e livadh prej 89220 m², të ndodhur në fshatin Gjinar, Elbasan, në parcelat me sipërfaqet dhe kufizimet sipas vendimit, nga e cila ka vendosur kthimin fizik për sipërfaqen 72097 m² dhe kompensimin, në një nga format e parashikuara nga ligji, për sipërfaqen 17123 m². Ky vendim është prishur me vendimin nr. 10-2012-1114 (548), datë 9.7.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës, dhe çështja është kthyer për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

6. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2324 (13-2013-6587), datë 21.11.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova, duke vlerësuar se dokumentet e paraqitura nga paditësi (kërkuksi) nuk janë të asnjë prej llojeve të dokumenteve që parashikohen nga ligji si akte për vërtetimin e pronësisë. Sipas gjykatës, me dokumentacionin e paraqitur, nuk provohet pronësia e shtetasit J.Xh. për pronat e pretenduara, ndaj vendimet e ZRKKP-së, Elbasan dhe ish-AKKP-së, Tiranë, që kanë rrëzuar kërkesën, janë të bazuara në ligj e në prova dhe nuk ka vend për

cenimin e tyre. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuksi.

7. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2015-1185 (523), datë 19.5.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se ai është marrë në zbatim korrekt të ligjit dhe është i bazuar në provat shkresore të nënshtruara shqyrtimit gjyqësor, ndërsa pretendimet e ngritura në ankim janë të pabazuara. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuksi.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1183, datë 19.3.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas Kolegjit Civil, shkaqet e parashtruara në rekurs ngrenë çështje të vlerësimit të provave dhe fakteve, të cilat dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ligjor të Gjykatës së Lartë.

9. Në datën 25.11.2024 kërkuksi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 6.12.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 5.3.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 6.3.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II. Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuksi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1. *Së drejtës për t'u njoftuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim*, sepse kërkuksi nuk ka marrë dijeni për datën dhe orën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, për shkak se nuk është njoftuar rregullisht dhe njoftimi nuk është realizuar sipas parashikimeve të KPC-së. Gjykata e apelit nuk e ka shqyrtuar çështjen në seancën e datës 5.5.2015, pasi njëri nga anëtarët e trupit gjykues ka pasur pengesa, ndaj ka urdhëruar njoftimin e palëve me shpallje për seancën e radhës. Shpallja për seancën gjyqësore të datës 19.5.2015 nuk është afishuar pranë gjykatës së shkallës së parë, në kundërshtim me nenin 460 të KPC-së, çka provohet nga aktet bashkëlidhur kërkesës (shkresa e kancelarit të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan), sipas së cilës, nga verifikimi dhe kontrolli pranë zyrës së arkivit, nuk rezulton të



jetë protokolluar shkresa për periudhën maj 2015 e dërguar nga gjykata e apelit.

10.2. Gjkata e Lartë, në lajthim, shprehet në vendimin e Kolegjit Civil se gjykimi në gjykatën e apelit është bërë në prani të palëve edhe pse kjo verifikohet nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit, sipas të cilit çështja është gjykuar në mungesë të palëve ndërgjyqëse. Kërkuesi mundi të paraqesë parashtrime në Gjykatën e Lartë vetëm në datën 15.3.2024, përmes shërbimit postar, dhe në sekretari ditën e hënë, datë 18.3.2024, pra brenda afatit 5-ditor nga njoftimi me shpallje i asaj gjykate i datës 4.3.2024. Nëse verifikohet relacioni i këshilltarit ligjor, ai është simetrik me vendimin dhe mban datën 15.3.2024, ditë e shpallur pushim me VKM-në nr. 156, datë 13.3.2024. Pra, ai daton përpara parashtrimeve të kërkuesit dhe qartazi nuk i ka marrë në konsideratë ato. Për pasojë, nuk është respektuar instrumenti ligjor i kërkuesit “për t’u dëgjuar shkresërisht” për të pasur akses në atë gjykatë dhe për të ngritur çështje që mund të merren parasysh edhe kryesisht nga Gjykata e Lartë.

10.3. Po ashtu, Gjykata e Lartë ka referuar në mënyrë të gabuar si subjekt suksesues të AKKP-së Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe jo Agjencinë e Trajtimit të Pronave, sipas ligjit. Në prizmin e seriozitetit të shqyrtimit të çështjes dhe gabimeve të tjera të konstatuara, edhe ky element cenon të drejtën për proces të rregullt.

11. **Subjekti i interesuar, Agjencia e Trajtimit të Pronave**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III. Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në

mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 19.3.2024, i cili i është njoftuar avokatit të kërkuesit përmes postës elektronike në datën 23.7.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 25.11.2024, dita e parë e punës pas festës zyrtare që përkon me datën 22.11.2024 (dita e premte). Sipas nenit 15, pika 3, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, kur afati mbaron në ditë pushimi ose feste, ai shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës ose jofestive. Për rrjedhojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor.

16. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se relacioni i këshilltarit ligjor jo vetëm që është simetrik me vendimin e Kolegjit Civil, çka provon qartazi se pretendimet e tij nuk janë marrë në konsideratë, por edhe mban datën 15.3.2024, ditë e shpallur pushim me VKM-në nr. 156, datë 13.3.2024.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se veprimtaria që ushtron këshilltari ligjor ka karakter këshillues dhe ndihmës, në ndryshim nga ajo e gjyqtarit, që ka karakter vendimmarrës. Rregullat procedurale që normojnë veprimtarinë e Gjykatës së Lartë kanë përcaktuar në mënyrë të qartë rolin dhe pozicionin, si dhe kompetencat e këshilltarit ligjor gjatë procesit të vendimmarrjes (*shih vendimet nr. 49, datë 5.10.2023; nr. 42, datë 19.9.2023,*



të Gjykatës Kushtetuese). Po sipas Gjykatës, kur pretendimet e ngritura kanë të bëjnë me mospërputhje në linjë dhe në arsyetim ndaj akteve të brendshme me natyrë përgatitore dhe ndihmuese dhe vendimeve përfundimtare, kontrolli kushtetues ushtrohet vetëm ndaj këtyre të fundit (*shih vendimin nr. 4, datë 31.1.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar, pasi jo vetëm që nuk është argumentuar nga pikëpamja kushtetuese cenimi i ardhur në të drejtat e tij për këtë shkak, por, nga ana tjetër, VKM-ja e referuar është e detyrueshme për zbatim ndaj administratës shtetërore dhe nuk është e detyrueshme për zbatim ndaj çdo institucioni tjetër që u përket pushteteve të tjera, në rastin konkret atij gjyqësor.

18. Kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u njoftuar dhe të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim, për shkak të mosmarrjes dijeni për datën dhe orën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, pasi nuk është njoftuar nga gjykata rregullisht sipas parashikimeve të KPC-së, me pasojë zhvillimin e gjykimit në mungesë të kërkuarit. Sipas kërkuarit, ky pretendim është ngritur edhe në Gjykatën e Lartë, e cila jo vetëm që nuk e ka marrë në shqyrtim atë, por madje, në lajthim, është shprehur se gjykimi në gjykatën e apelit është bërë në prani të palëve. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkuarit dhe argumentet e parashtruara në mbështetje të tyre, si dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit të kontrollit kushtetues vlerëson t'i shqyrtojë ato, në vijim, në drejtim të respektimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit

19. Kërkuari ka pretenduar se ai nuk ka marrë dijeni për datën dhe orën e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit, pasi nuk është njoftuar rregullisht dhe njoftimi nuk është realizuar sipas parashikimeve të KPC-së. Sipas tij, shpallja për seancën gjyqësore të datës 19.5.2015 nuk është afishuar në gjykatën e shkallës së parë, në kundërshtim me nenin 460 të KPC-së, çka provohet nga shkresa e kancelarit të Gjykatës të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, sipas së cilës, nga verifikimi dhe kontrolli pranë zyrës së arkivit, nuk rezulton të

jetë protokolluar shkresa për periudhën maj 2015 e dërguar nga gjykata e apelit. Sipas kërkuarit, pretendimi për mosshpalljen e datës së seancës në gjykatën e shkallës së parë, që ka sjellë mosmarrjen dijeni prej tij për gjykimin në gjykatën e apelit, është ngritur edhe në Gjykatën e Lartë, por kjo e fundit, në lajthim, ka konsideruar në vendim se gjykimi është bërë në prani të palëve, edhe pse nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit konstatohet se çështja është gjykuar në mungesë. Kërkuari ka pretenduar se ai ka mundur të paraqesë parashtrime në Gjykatën e Lartë vetëm në datën 15.3.2024, përmes shërbimit postar, dhe në sekretari ditën e hënë, datë 18.3.2024, pra brenda afatit 5-ditor nga njoftimi me shpallje i asaj gjykate i datës 4.3.2024.

20. Në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nga ana tjetër, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit edhe nga neni 142, pika 1, i Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Po kështu, Gjykata ka theksuar se mospasqyrimi në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë i shkaqeve të parashtruara nga kërkuari në shtesën e rekursit, përbën cenim të



standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimin nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në kuptim të standardeve të mësipërme dhe referuar fakteve me natyrë kushtetuese të rezultuara gjatë këtij gjykimi, Gjykata do të verifikojë në vijim nëse në rastin konkret kërkuksi ka parashtruar përpara Gjykatës së Lartë pretendime me natyrë kushtetuese për procesin gjyqësor objekt rekursi dhe nëse ajo gjykatë ka ushtruar rolin e saj subsidiar në trajtimin e këtyre pretendimeve.

23. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për nevoja të këtij gjykimi, konstaton se kërkuksi në datën 5.12.2013 ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës për kundërshtimin e vendimit nr. 2324 (13-2013-6587), datë 21.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Seanca e parë gjyqësore në atë gjykatë është zhvilluar në datën 5.5.2015 dhe referuar procesverbalit të asaj seance rezulton se asnjë nga palët ndërgjyqëse nuk është paraqitur në gjykim. Sipas gjykatës së apelit paditësi (kërkuksi) nuk është paraqitur, edhe pse ka marrë dijeni me shpalljen e datës 10.4.2015. Po nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se me kërkesën e datës 5.5.2015 një nga anëtarët e trupit gjykues ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, pasi kishte pengesa ligjore për të marrë pjesë në gjykim, kërkesë kjo që është pranuar, për rrjedhojë është vendosur shtyrja e seancës gjyqësore në datën 19.5.2015, duke u urdhëruar sekretaria për njoftimin e palëve me shpallje. Në dosjen gjyqësore është administruar lista e shpalljes së seancës gjyqësore, si dhe shkresa “Shpallje” e datës 6.5.2015 për njoftimin e seancës së radhës të datës 19.5.2015.

24. Në seancën gjyqësore të datës 19.5.2015, referuar procesverbalit të saj, konstatohet se sërish asnjë nga palët ndërgjyqëse nuk ka qenë e pranishme në gjykim dhe gjykata e apelit ka vendosur zhvillimin e gjykimit “*në mungesë të palëve ndërgjyqëse, të cilat nuk u paraqitën edhe pse kishin dijeni me listë shpalljeje*”. Në përfundim të kësaj seance Gjykata e Apelit Durrës ka shpallur vendimin, duke lënë në fuqi vendimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, pasi ka vlerësuar se pretendimet e ngritura nga paditësi (kërkuksi) në ankim janë po ato të ngritura gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallën e parë, për të cilat ajo gjykatë ka arsyetuar se përse nuk duhen pranuar, duke iu referuar dispozitave konkrete të ligjit material e procedural, përfundime që gjykata e apelit i ka gjetur të drejta.

25. Në datën 15.6.2015 kërkuksi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së apelit, duke ngritur, në thelb, të njëjtat pretendime që ka ngritur edhe përpara gjykatave të faktit, duke kundërshtuar në tërësi atë proces. Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të asaj gjykate, Gjykata konstaton se në datën 4.3.2024 është publikuar lista e çështjeve civile për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 19.3.2024, ku përfshihej edhe çështja e kërkuksit. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton edhe se pas publikimit të kësaj date kërkuksi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me aktin “Pretendime” të nënshkruar nga avokati i tij, i cili mban datën 15.3.2024 dhe është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 18.3.2024, një ditë përpara datës së shpallur për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit, ku ka ngritur në mënyrë të shprehur pretendimin për mosmarrjen dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore në gjykatën e apelit.

26. Me vendimin nr. 00-2024-1183, datë 19.3.2024, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk kishte shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas atij kolegji, gjykata e apelit ka interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin (material dhe atë procedural) që ka shërbyer për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ka arsyetuar në mënyrë ezauruese shkakun e vendimmarrjes, nuk janë shkelur dispozitat për juridiksionin dhe kompetencën lëndore, funksionale dhe as tokësore ekskluzive, përbërja e trupës gjykuese ka qenë në rregull dhe nuk ka pasur shkaqe papajtueshmërie, çështja është shqyrtuar në prani të palëve ndërgjyqëse dhe nuk konstatohen shkelje lidhur me procesin e njoftimit të tyre (*shih paragrafin 36 të vendimit të Kolegjit Civil*).

27. Gjykata vëren se kërkuksi, në mbështetje të pretendimit të tij për mosrespektimin e dispozitave të KPC-së për shpalljen e datës së seancës të datës 19.5.2015 në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur bashkëlidhur ankimit kushtetues edhe shkresën “Kthim përgjigje” nr. 1761 prot., datë 16.10.2024 të kancelarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, sipas së cilës, në përgjigje të kërkesës së kërkuksit për informacion pranë kësaj gjykate nëse ishte protokolluar dhe afishuar shpallja nr. 1239 sistemi, datë 6.5.2015 e Gjykatës së Apelit Durrës për periudhën maj 2015, e ka informuar, se: “nga verifikimi dhe kontrolli i ushtruar



pranë Zyrës së Arkivit nuk rezultojn të jetë e protokolluar kjo shkruesë për periudhën maj 2015 të dërguar nga Gjykata e Apelit Durrës”.

28. Gjykata, bazuar në sa më sipër, në situatën që kërkuar rezultojn se nuk ka qenë i pranishëm në seancat gjyqësore të zhvilluara në gjykatën e apelit dhe në situatën që ai e ka ngritur një pretendim të tillë përpara Gjykatës së Lartë, i takonte kësaj të fundit që të verifikonte bazueshmërinë në themel të këtij pretendimi me natyrë kushtetuese, për sa kohë që prania fizike në procesin gjyqësor lidhet drejtpërdrejt me garantimin e të drejtave të tjera procedurale të palëve në këndvështrim të së drejtës për proces të rregullt.

29. Gjykata ka theksuar se raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme udhëhiqet nga parimi i *subsidiaritetit*. Respektimi i të drejtave kushtetuese është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Roli i kësaj gjykate, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se, referuar natyrës kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në Gjykatën e Lartë për cenimin e së drejtë për t'u njohur dhe dëgjuar në procesin gjyqësor në gjykatën e apelit, ajo gjykatë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në këtë drejtim. Mungesa e pasqyrimin në vendim të shkaqeve të paraqitura nga kërkuar në aktin “Pretendime”, të depozituar pas publikimit të datës së seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë, si dhe mosdhënia atyre përgjigje të arsyetuar, edhe pse këto shkaqe janë dukshëm me natyrë kushtetuese, pasqyren cenim të së drejtës së aksesit. Për rrjedhojë mospranimi i rekursit duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, vë në dyshim respektimin e së drejtës së aksesit në atë gjykatë, e cila përfshin edhe të drejtën për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e tij.

31. Gjykata vëren, gjithashtu, se Gjykata e Lartë në vendimin e saj është shprehur se “*çështja është*

shqyrtuar në prani të palëve ndërgjyqëse...”, ndërkohë që, siç konstatohet lehtësisht nga aktet e administruara në gjykim dhe nga vetë përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit, gjykimi në atë gjykatë është bërë në mungesë të të dyja palëve ndërgjyqëse. Kjo e dhënë e gabuar në vendimin e Gjykatës së Lartë është e tillë që vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt edhe në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit. Për më tepër, po në drejtim të këtij standardi, Gjykata konstaton se në vendimin e Gjykatës së Lartë ka edhe një gabim material që ka të bëjë me të dhënat e palëve ndërgjyqëse, ku si palë e paditur është shënuar si subjekt suksesues i AKKP-së, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe jo Agjencia e Trajtimit të Pronave.

32. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuar për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit në Gjykatën e Lartë janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1183, datë 19.3.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.9.2025.

Shpallur më 10.11.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtar: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferrllari, Sonila Bejtja, Marjana Semini

Anëtar kundër: Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim

**MENDIM PAKICE**

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Kostandin Xholli, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 10-2015-1185(523), datë 19.5.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 00-2024-1183, datë 19.3.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, jemi kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar për shkak të pabazueshmërisë në themel të pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

2. Kërkuesi e ka mbështetur këtë pretendim në faktin se në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk gjejnë pasqyrim shkaqet e parashtruara prej tij në shtesën e rekursit, të cilat, për këtë shkak, as nuk janë marrë në shqyrtim prej asaj gjykate. Shumica, pasi ka marrë në shqyrtim këtë pretendim, ka arritur në përfundimin se mungesa e pasqyrimit në vendim të shkaqeve të paraqitura nga kërkuesi në aktin “Pretendime”, të depozituar pas publikimit të datës së shqyrtimit të rekursit në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë, si dhe mosdhënia atyre përgjigje të arsyetuar, edhe pse këto shkaqe janë dukshëm me natyrë kushtetuese, passjell cenim të së drejtës së aksesit. Për rrjedhojë, sipas shumicës, mospranimi i rekursit duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese që ka të bëjë me cenimin e së drejtës për t’u njoftuar dhe dëgjuar në procesin gjyqësor në gjykatën e apelit, vë në dyshim respektimin e së drejtës së aksesit në atë gjykatë, e cila përfshin edhe të drejtën për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e tij. Po sipas shumicës, Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, referuar natyrës kushtetuese të këtyre pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në aktin “Pretendime”, duhej të kishte mbajtur qëndrim të shprehur në këtë drejtim (*shih paragrafët 30-31 të vendimit*).

3. Ne, gjyqtarët në pakicë, nuk pajtohemi me këtë vlerësim të shumicës. Për këtë mbajmë në konsideratë faktet në lidhje me parashtrimet, shtesën e rekursit, sikurse ato janë pasqyruar kronologjikisht dhe në mënyrë të përmbledhur edhe nga shumica (*shih paragrafin 25 të vendimit*), në referim të të cilave mund të analizohet se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës mban datën 19.5.2015 dhe kërkuesi në datën

15.6.2015 ka ushtruar të drejtën e rekursit për kundërshtimin e atij vendimi. Në vijim, pas publikimit të listës së çështjeve civile për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 19.3.2024, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesit, pra pas rreth 9 vjetësh nga paraqitja e rekursit, ai i është drejtuar Gjykatës së Lartë me aktin “Pretendime” të nënshkruar nga avokati i tij, i cili mban datën 15.3.2024 dhe është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 18.3.2024, që do të thotë vetëm një ditë përpara datës së planifikuar dhe të shpallur për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit. Në këtë akt kërkuesi ka ngritur shkaqe të reja për të mbështetur kërkimin e tij për shfuqizimin e vendimit objekt ankimi, siç është ai për mosmarrjen dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore në gjykatën e apelit.

4. Për rrjedhojë, akti “Pretendime”, që përbën shtesë të shkaqeve të rekursit, daton shumë vjet pas paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë, pra pas kalimit të afatit ligjor për ushtrimin e së drejtës së rekursit. Dispozitat procedurale civile që parashikojnë mjetet dhe afatet e ankimit në Gjykatën e Lartë (neni 442 i KPC-së), sipas përmbajtjes së tyre në kohën e ushtrimit të rekursit, kanë parashikuar afatin 30-ditor për paraqitjen e këtij mjeti ankimi (neni 443 i KPC-së), afat ky që fillonte nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar (neni 444 i KPC-së). Po kështu, sipas dispozitave procedurale civile, shkaqet e rekursit janë përcaktuese për kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga ajo gjykatë (neni 473/a i KPC-së). Referuar këtyre rregulimeve ligjore, kohëzgjatja e procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, pra periudha kohore nga paraqitja/regjistrimi i rekursit/çështjes dhe deri në shqyrtimin e tij nga kolegj i në dhomën e këshillimit/seancë gjyqësore, nuk nënkupton dhe as mund të shërbejë si shkak për t’i dhënë palës rekursuese të drejtën për të paraqitur vazhdimisht dhe në çdo kohë pretendime ose shkaqe të reja për kundërshtimin e procesit gjyqësor në gjykatat e faktit, përtej atyre të parashtruara në rekurs dhe as për të zgjeruar kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë.

5. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022*;



nr. 18, datë 31.3.2014; nr. 17, datë 19.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese). Po ashtu, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se nuk është arbitrar interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë për papranueshmërinë e shtesës së rekursit, interpretim sipas të cilit, bazuar në nenin 473/a të KPC-së, ajo e shqyrton çështjen brenda kufijve të rekursit, përveç rasteve kur ligji i jep të drejtën të investohet kryesisht, ndërkohë që në kushtet kur shqyrtimi gjyqësor kufizohet vetëm brenda shkaqeve të parashtruara në rekurs, shkaqet e reja të parashtruara në shtesën e rekursit nuk mund të merren në vlerësim, pasi për shkak të ligjit janë të papranueshme (*shih vendimin nr. 30, datë 18.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Për rrjedhojë, çdo shkak i paraqitur gjatë kohës që çështja është në pritje të shqyrtimit të saj në Gjykatën e Lartë, në rastin konkret dukshëm jashtë afatit ligjor për atë mjet ankimi, nuk mund të merret në shqyrtim nga ajo gjykatë, pra të marrë përgjigje përfundimtare lidhur me (pa)bazueshmërinë në ligj.

7. Po sipas shumicës, Gjykata e Lartë në vendimin e saj është shprehur se “*çështja është shqyrtuar në prani të palëve ndërgjyqëse...*”, ndërkohë që, nga aktet e administruara në gjykim dhe nga vetë përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit, gjykimi në atë gjykatë është bërë në mungesë të të dyja palëve ndërgjyqëse. Sipas shumicës, kjo e dhënë e gabuar në vendimin e Gjykatës së Lartë është e tillë që vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt edhe në drejtëm të standardit të arsytimit të vendimit. Për më tepër, po në drejtëm të këtij standardi, shumica ka vlerësuar se në vendimin e Gjykatës së Lartë ka edhe një gabim material që ka të bëjë me të dhënat e palëve ndërgjyqëse, ku si palë e paditur është shënuar si subjekt suksesues i AKKP-së, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe jo Agjencia e Trajtimit të Pronave (*shih paragrafin 31 të vendimit*).

8. Për ne, gjyqtarët në pakicë, edhe pse dukshëm në vendimin e Gjykatës së Lartë ka një pasaktësi në lidhje me praninë e palëve në gjykimin në gjykatën e apelit, i cili, siç rezulton nga aktet e dosjes gjyqësore, është zhvilluar në mungesë të të dyja palëve ndërgjyqëse, kjo pasaktësi nuk është e tillë që të vërë në dyshim atë vendimmarrje. Po ashtu, edhe gabimi material që ka të bëjë me të dhënat e palëve ndërgjyqëse, ku si palë e paditur është shënuar si subjekt suksesues i AKKP-së, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe jo Agjencia e Trajtimit të Pronave, nuk është argumentuar se përse e bën të cenueshëm

vendimin në situatën që kërkuesi në lidhje me këtë aspekt nuk ka argumentuar nga pikëpamja kushtetuese pasojat në të drejtën e tij për proces të rregullt, apo se një pasaktësi e tillë në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë e bën vendimin alogjik ose arbitrar. Në këtë drejtëm vlen të përmendet se në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimet nr. 30 datë 18.4.2024; nr. 9, datë 26.2.2015; nr. 21, datë 1.10.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Për sa më lart, ne jemi të qëndrimit se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, ndaj kërkesa duhej të rrëzohej për shkaqet si më sipër.

Anëtar: Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci

VENDIM

Nr. 779, datë 31.10.2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E EMËRIMIT NË POZICIONIN E KRYETARIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DHE TË DYTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147, pika 1 dhe 147/“a”, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 86, 97, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, nenet 47, pika 6, 52, 57 pika 3, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 26, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për kriteret dhe procedurën e emërimit në pozicionin e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, sipas tekstit



dhe aneksit 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe përbëjnë pjesë përbërëse të tij.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi

RREGULLA

PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E
EMËRIMIT NË POZICIONIN E KRYETARIT
TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DHE
TË DYTË

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të detajuara mbi kriteret dhe procedurën e ngritjes në detyrën e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, bazuar në parimet e meritokracisë dhe të zhvillimit të karrierës, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht atyre të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit, si dhe proporcionalitetit.

Neni 2
Objekti

1. Kjo rregullore parashikon rregulla të detajuara, të cilat përcaktojnë:

a) procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, përfshirë kontrollin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë;

b) kriteret për vlerësimin etik dhe profesional ndërmjet magistratëve me nivele vlerësimi të njëjta;

c) kriteret për matjen e aftësive organizative dhe drejtuese;

ç) procedurën që ndiqet në rastin e rezultateve të barabarta;

d) procedurën e renditjes së kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë.

2. Rregullat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme për gjyqtarët që kandidojnë për ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Akt vlerësimi” nënkupton aktin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatit, i cili është administruar në dosjen personale të tij;

b) “Dosje personale” nënkupton dosjen e kandidatit sipas përcaktimeve të nenit 38 të Ligjit për Statusin;

c) “Gjykatë e shkallës së parë” nënkupton “Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm”, “Gjykatat administrative të shkallës së parë” dhe “Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”;

ç) “Gjykatë e shkallës së dytë” nënkupton “Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, “Gjykatën Administrative të Apelit” dhe “Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”;

d) “Kandidat në procedurën e ngritjes në detyrën e kryetarit të gjykatës” është gjyqtari që kandidon për emërimin në detyrën e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë;

dh) “Kandidat në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrën e kryetarit” është kandidati i kualifikuar për emërim në detyrën e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, i cili ka dy vlerësime etike dhe profesionale;

e) “Këshilli” nënkupton Këshillin e Lartë Gjyqësor;

ë) “Mbledhje plenare” nënkupton mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

f) “Komisioni” nënkupton Komisionin e Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor;

g) “Struktura e posaçme” nënkupton personat përgjegjës të caktuar me urdhër të Kryetarit të



Këshillit për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimi nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”;

gj) “Në të njëjtën shkallë” nënkupton përvojën profesionale si gjyqtar i shkallës së parë ose si gjyqtar i shkallës së dytë në varësi të gjykatës ku kandidati për kryetar shpreh interesin për kandidim;

h) “Ngritja në detyrë” në kuptim të kësaj rregulloreje është kalimi nga një pozicion si gjyqtar, në pozicionin e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë ose të dytë, sipas nenit 47, pika 1, shkronja “c” dhe pika 6, të Ligjit për Statusin;

i) “Vlerësimet të mëparshme” nënkupton dy vlerësimet më të fundit etike dhe profesionale që kandidati ka në momentin e kandidimit;

j) “Nivel vlerësimi” nënkupton rezultatin e përgjithshëm të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatit, sipas sistemit të vlerësimit të kohës, përfshirë edhe atë të gradimit për periudhën e përcaktuar në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 171, pika 5, të Ligjit për Statusin;

k) “Periudhë kalimtare” nënkupton periudhën deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

l) “Përvojë në pozicione drejtuese në administratën publike” nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit në administratën publike, në pozicione drejtuese të përcaktuara sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ose në pozicione të barasvlershme me to, të ushtruara përpara fitimit të statusit të magjistratit;

ll) “Përvojë në pozicione drejtuese në drejtësi” nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit në ushtrimin e funksioneve drejtuese brenda sistemit gjyqësor, duke përfshirë detyrën e kryetarit të një gjykate të shkallës më të ulët, funksionin e kryetarit apo kryetarit të komanduar të gjykatës të emëruar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, si dhe çdo pozicion tjetër të barasvlershëm që

përfshin ushtrimin e përgjegjësi drejtuese në strukturat e sistemit gjyqësor;

m) “Skemë pikëzimi” nënkupton sistemin e përcaktuar në këtë vendim dhe në aneksin 1 të tij, që përdoret për renditjen e kandidatëve me nivel të njëjtë vlerësimi, përmes dhënies së pikëve mbi bazën e kriterëve përbërës të vlerësimit të posaçëm, në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e kryetarit të gjykatës;

n) “Vend i lirë për pozicionin e kryetarit të gjykatës” nënkupton situatën kur për kryetarin e gjykatës së shkallës së parë ose të dytë verifikohet një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit ose kur ai ka dhënë dorëheqjen gjatë ose në fund të mandatit, ose kur atij nuk i pranohet kërkesa për një mandat tjetër;

nj) “Procedurë ngritjeje në detyrën e kryetarit të gjykatës” nënkupton procesin administrativ që përfshin procedurën e verifikimit dhe atë të përzgjedhjes së kandidatëve, për një vend të lirë në pozicionin e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë ose të dytë, që finalizohet me vendimin e emërimit të kandidatit të renditur më lart;

o) “Procedurë verifikimi të kandidatit” është procesi administrativ i verifikimit të plotësisht nga kandidati të kriterëve ligjorë të kandidimit për ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë ose të dytë, si dhe të pasurisë dhe figurës;

p) “Procedurë përzgjedhjeje” është procesi administrativ i renditjes së kandidatëve në një procedurë ngritjeje në detyrën e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë ose të dytë, me qëllim identifikimin e kandidatit të renditur më lart;

q) “Relator” është anëtar i përhershëm ose zëvendësues i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili zgjidhet me short për të realizuar procedurën e verifikimit të një kandidati ose procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë ose të dytë;

r) “Vendim kualifikimi” është vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor që merret për një kandidat në përfundim të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit, të pasurisë dhe të figurës;

rr) “Vendim për renditjen e kandidatëve” është vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor që merret gjatë një procedure përzgjedhjeje për ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë ose të dytë, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 52, pika 10, të Ligjit për Statusin, si dhe në rregullat e detajuara



për kriteret dhe procedurën, të përcaktuara në këtë vendim;

s) “Vendim emërimi” është vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor për emërimin në detyrën e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë ose të dytë, të kandidatit të renditur më lart në një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë;

sh) “Vjetërsi si gjyqtar” nënkupton përvojën e përgjithshme të punës së kandidatit, si gjyqtar, si gjyqtar i komanduar në institucionet e sistemit të drejtësisë, dhe si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

t) “Vjetërsi si jurist” nënkupton përvojën e përgjithshme të punës së kandidatit si jurist në institucione publike, subjekte shtetërore dhe private.

Neni 4 Kuatr ligjor

1. Kjo rregullore do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me:

a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
b) Kodin e Procedurave Administrative;
c) ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (Ligji për Qeverisjen);

ç) ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin);

d) ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;

dh) ligjin nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

e) ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;

ë) ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;

f) ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;

g) ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;

gj) ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

h) ligjin nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

i) ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;

j) ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësit civilë”, i ndryshuar.

PJESA II VERIFIKIMI I KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 5 Shpallja e vendit të lirë

1. Këshilli publikon shpalljen për vendin e lirë për pozicionin e kryetarit të gjykatës për kandidatët që plotësojnë kriteret e ngritjes në detyrë: kur vendi është i lirë, kur kryetari në detyrë jep dorëheqjen ose kur nuk i pranohet kërkesa për një mandat tjetër.

2. Shpallja e vendit të lirë publikohet jo më vonë se tre muaj para mbarimit të mandatit të kryetarit në detyrë. Këshilli, me propozim të Komisionit, vendos për publikimin e vendit të lirë dhe i bën thirrje trupës gjykuese të gjykatës përkatëse për paraqitjen e shprehjes së interesit.

3. Nëse në gjykatën ku është krijuar një vend i lirë i përhershëm nuk ka kandidatë, brenda periudhës nga dy muaj para përfundimit të mandatit të kryetarit deri në tre muaj pas përfundimit të tij, thirrja për kandidim u drejtohet çdo gjyqtari që plotëson kriteret për kryetar.

Neni 6 Publikimi i shpalljes

1. Vendimi për shpalljen e pozicionit të lirë, duhet të përmbajë:

a) kriteret ligjore të kandidimit;

b) afatin e aplikimit, i cili mund të jetë nga dy deri në katër javë nga data e shpalljes. Ky afat, kur është e nevojshme, mund të shtyhet me vendim të arsyetuar të Këshillit;

c) informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm që i bashkëlidhet aplikimit;



ç) procedurën e aplikimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

2. Vendimi për shpalljen e vendit të lirë në pozicionin e kryetarit të gjykatës publikohet në faqen zyrtare të Këshillit, si dhe në faqen zyrtare të gjykatës.

Neni 7

Paraqitja e aplikimit dhe dokumentacioni i kërkuar

1. Kandidati për pozicionin e lirë të shpallur paraqet kërkesën me shkrim për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur, e cila shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) një jetëshkrim të përditësuar;

b) vetëdeklarim për mospasjen e masës disiplinore në fuqi;

c) vetëdeklarim për mosqenien në situatë të papajftueshmërisë ambientale, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

ç) një platformë personale të qëllimeve dhe objektivave që kandidati propozon të ndjekë, në rast të ngritjes në detyrë si kryetar i gjykatës përkatëse, e cila duhet të përmbajë, ndër të tjera:

i. një plan të detajuar mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave të kryetarit të gjykatës, duke parashtruar qëndrimin e kandidatit mbi mënyrën më efektive të realizimit të tyre, pa cenuar pavarësinë funksionale të gjyqtarëve;

ii. një plan i detajuar për drejtimin e gjykatës, zhvillimin institucional dhe rritjen e efektivitetit të saj;

iii. një plan mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të gjykatës, përfshirë aspektet administrative që lidhen me ushtrimin e funksioneve gjyqësore;

iv. vlerësimin e situatës aktuale të gjykatës përkatëse gjatë trevjeçarit të fundit dhe vizionin e kandidatit lidhur me sfidat kryesore me të cilat përballlet kjo gjykatë, duke përcaktuar hapat dhe masat për përballimin e tyre, si dhe arsyet e përzgjedhjes së këtyre masave;

v. hapat dhe masat që kandidati parashikon të ndërmarë për të rritur nivelin e besueshmërisë së publikut në sistemin gjyqësor;

vi. hapat dhe planifikimet që synojnë evidentimin dhe garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në veprimtarinë gjyqësore;

d) Çdo dokument tjetër që kërkohet nëpërmjet thirrjes për kandidim ose që kandidati vlerëson të vlefshëm të paraqesë.

2. Shprehja e interesit dhe të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen pranë Këshillit brenda afatit të përcaktuar në thirrje, në zyrën e protokollit të Këshillit, në adresën postare ose në adresën elektronike të përcaktuar në thirrjen për paraqitjen e shprehjeve të interesit.

Neni 8

Fillimi dhe fazat e procedurës së verifikimit

1. Procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendim të Këshillit, jo më vonë se shtatë ditë nga përfundimi i afatit të aplikimit për ngritjen në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës.

2. Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Komisionit, të relatorit për secilin kandidat. Shorti realizon shpërndarjen rastësore dhe të barabartë, në vijimësi, të ngarkesës së punës, midis anëtarëve të Komisionit. Këshilli, për arsye të motivuara, mbi kërkesën e çdo anëtari të Komisionit, mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti.

3. Përjashtimisht, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi propozimin e Komisionit, Këshilli mund të vendosë që në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.

4. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, sipas neneve 72, 73, 74 dhe 75, të Ligjit për Qeverisjen, lidhur me verifikimin e një kandidati të caktuar, përpara fillimit të procedurës së shortit për atë kandidat apo në çdo kohë kur vjen në dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procesin e verifikimit, në mbledhjet e Komisionit ose në mbledhjen plenare të Këshillit për rastin e atij kandidati.



5. Për dorëheqjen e çdo anëtari të Këshillit vendos Kryetari i tij. Kur dorëheqjen e jep Kryetari i Këshillit, vendimi merret nga Zëvendëskryetari i tij.

6. Relatori i çështjes kujdeset për zhvillimin e procedurës administrative të verifikimit dhe sidomos për sa më poshtë:

a) shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga kandidati;

b) përgatitjen e projektaktit administrativ;

c) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;

ç) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;

d) njoftimet për kandidatin.

7. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve realizohet në dy faza kryesore:

a) vlerësimi i kushteve dhe kriterëve formale, të përcaktuara në pikën 6, të nenit 47, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

b) verifikimi i kushteve dhe kriterëve për pasurinë dhe figurën, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të ligjit nr. 96/2016.

8. Për realizimin e fazave të parashikuara në pikën 7 të këtij neni, procedura zhvillohet përmes këtyre hapave:

a) veprimet paraprake të relatorit të çështjes;

b) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes;

c) shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Komisioni;

d) shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Këshilli.

Neni 9

Të drejtat e kandidatit

1. Kandidati ka të drejtë të njoftohet për relatorin e çështjes menjëherë me fillimin e procedurës së verifikimit.

2. Kandidati ka të drejtë që, brenda tri ditëve nga njoftimi për relatorin e çështjes, të kërkojë përjashtimin e tij kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75 të Ligjit për Qeverisjen dhe relatori nuk ka hequr dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtari tjetër të Këshillit.

3. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e relatorit të çështjes dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit.

4. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli për verifikimin e kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë vendim.

5. Kryesisht apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e tij, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

6. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, Komisioni vendos përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Komisionit për përfundimin e procedurës së verifikimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

Neni 10

Afatet dhe llogaritja e tyre

1. Afatet në procedurën e verifikimit të kandidatëve caktohen në ditë kalendarike.

2. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligj ose në këtë rregullore, në llogaritjen e afatit përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

3. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

4. Dita e fundit e afatit të kryerjes së veprimit procedural, paraqitjes së kërkesave dhe shpjegimeve, vazhdon deri në orën 24⁰⁰ të saj. Afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa, shpjegimet ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.

Neni 11

Njoftimet

1. Njoftimet e Këshillit drejtuar kandidatit gjatë procedurës së verifikimit bëhen me shkresë, në adresën postare ose në adresën elektronike zyrtare apo atë të deklaruar për këtë qëllim, pranë Këshillit.



2. Njoftimet dhe kërkesat e kandidatit drejtuar Këshillit bëhen me shkrim, duke i depozituar drejtpërdrejt pranë Këshillit ose në adresën e tij elektronike, adresë e cila iu është bërë e njohur për këtë qëllim secilit kandidat, me fillimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave apo përmes publikimit të saj në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Kandidati ka detyrimin të njoftojë menjëherë me shkrim Këshillin për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës postare dhe elektronike të deklaruar.

KREU II VLERËSIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE FORMALE TË KANDIDIMIT

Neni 12

Veprimet paraprake të relatorit të çështjes

1. Pas caktimit me short, relatori i çështjes njofton kandidatin për fillimin e procedurës së verifikimit, duke i bërë të ditur të drejtën që ka për të kërkuar përjashtimin e tij dhe/ose të çdo anëtarë të Këshillit. Njëkohësisht, relatori i dërgon kandidatin, në rrugë elektronike, formularin deklarues me të dhënat e adresës postare, adresës elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllime të procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, të cilin kandidati e nënshkruan dhe e dorëzon fizikisht.

2. Në rast se kandidati paraqet kërkesë për përjashtimin e relatorit të çështjes, Këshilli vendos jo më vonë se tri ditë nga depozitimi i saj. Nëse relatori i çështjes përjashtohet, Këshilli zhvillon menjëherë procedurat e shortit për caktimin, ndërmjet dy anëtarëve të tjerë dhe/ose atij zëvendësues të Komisionit, të relatorit të çështjes për atë kandidat.

Neni 13

Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit

1. Relatori i çështjes kryen veprimet procedurale dhe verifikuese që kanë për qëllim verifikimin e përmbushjes së kërkesave ligjore nga kandidati, lidhur me përvojën profesionale minimale prej shtatë vjetësh, nga të cilat të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe periudhën e ushtrimit të funksionit si gjyqtar i komanduar, mospasjen e masave disiplinore në fuqi, si dhe

respektimin e afatit trevjeçar nga mbarimi i mandatit për kandidatët që kanë qenë më parë anëtarë të Këshillit.

2. Relatori i çështjes ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisionit dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit të çështjes.

3. Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, mbi paanësinë e administratës publike zbatohen edhe për nëpunësit e Njësive Mbështetëse të Komisionit dhe personelin administrativ të Këshillit.

4. Kryetari i Këshillit është përgjegjës për marrjen e vendimeve për përjashtimin nga vendimmarrja ose konfirmimin e nëpunësve civilë në rast të shfaqjes së konfliktit të interesit.

Neni 14

Shqyrtimi dhe përfundimi i procedurës së verifikimit

1. Nëse në përfundim të këtyre procedurave administrative për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, relatori i çështjes vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin përjashtimin e kandidatit, procedon me përgatitjen e çështjes dhe të relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit. Komisioni, nëse verifikimet janë të plota, vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

2. Nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, relatori i çështjes, bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit, pasi vë në dijeni Komisionin, me vendim të këtij të fundit, njofton kandidatin e verifikuar lidhur me gjetjet paraprake, si edhe për të drejtën që:

a) brenda një afati pesëditor nga dita e njoftimit, të paraqesë me shkrim, drejtpërdrejt pranë zyrës përkatëse të Këshillit ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse, lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit, si edhe të dokumentacionit mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të kandidatit;



b) të tërheqë, sipas rastit, kopje të dokumentacionit dhe të akteve të këtij procedimi administrativ ose të asaj pjese të tyre që lidhet me verifikimin e kushteve dhe kriterëve përkatëse ligjore, për të cilat relatori ka vlerësuar paraprakisht se mund të sjellin përjashtimin e kandidimit.

3. Në pamundësi objektive ose për motive të tjera të justifikuar për të paraqitur qëndrimin dhe shpjegimet brenda afatit pesëditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin, duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Kur i vlerëson motivet si të justifikuar, relatori i çështjes i cakton kandidatin një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

4. Në rastin kur, në përfundim të afatit të njoftimeve sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, kandidati nuk paraqitet, nuk i përgjigjet njoftimeve të Këshillit, nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar ose nuk parashtron shpjegime me shkrim për gjetjet e procedurës së verifikimit, relatori i çështjes procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe problemet ligjore të konstatuara dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim përpara Komisionit. Komisioni, nëse verifikimet janë të plota, vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

Neni 15

Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Këshilli

1. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga Kryetari i Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke i dërguar anëtarëve materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga ajo e njoftimit të Kryetarit të Komisionit.

2. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori i çështjes, i njoftohet kandidatin. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Në mbledhjen e Këshillit, Kryetari i Këshillit fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e procedurave, të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurave për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore nga kandidati i verifikuar.

4. Në përfundim të parashtrimeve të relatorit të çështjes, nëse vlerësojnë, anëtarët e Këshillit mund

t'i drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

5. Nëse anëtarët e Këshillit nuk parashtrojnë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit të çështjes, Këshilli deklaron kalimin në fazën e bisedimit, votimit dhe të dhënies së vendimit.

6. Pas bisedimit dhe votimit të çështjes, Këshilli vendos kualifikimin e kandidatin dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të verifikimit të kushteve dhe kriterëve për pasurinë dhe figurën për ngritje në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose përjashtimin e kandidatin nga procedura e ngritjes në detyrë, nëse ai nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret ligjore të kandidimit.

Neni 16

Vendimi i verifikimit dhe e drejta e ankimit

1. Vendimi i verifikimit arsyetohet sipas kërkesave të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ.

2. Vendimi i verifikimit njoftohet sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit të Statusit dhe bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimitatit të subjekteve.

3. Ndaj vendimit të përjashtimit të Këshillit për procedurën e verifikimit, kandidati mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda pesë ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

KREU III

VERIFIKIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE PËR PASURINË DHE FIGURËN

Neni 17

Verifikimi i pasurisë së kandidatin

1. Jo më vonë se tre ditë nga vendimi i Këshillit për kualifikimin e kandidatin dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të verifikimit të kushteve dhe kriterëve për pasurinë, dhe figurën për ngritje në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës, relatori njofton kandidatin për plotësimin në formë elektronike të formularit “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatin për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”.



2. Njëkohësisht, për t'i mundësuar Këshillit, në zbatim të pikës 2, të nenit 32 të Ligjit të Statusit, të kryejë verifikimin dhe të kërkojë raportim, informacion dhe dokumentacion nga institucioni kompetent për verifikimin e pasurisë, ILDKPKI-ja, si dhe nga organet e administratës tatimore dhe doganore, me të dhëna mbi pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur, kandidatit i dërgohen, në rrugë elektronike, formularët e mëposhtëm:

a) "Formulari për dhënien e miratimit për përpunimin e të dhënave personale";

b) "Formulari autorizues për verifikimin pranë të gjitha subjekteve publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë".

3. Autorizimet, të nënshkruara rregullisht nga kandidati dhe personat e lidhur, depozitohen pranë zyrës së posaçme të Këshillit, jo më vonë se pesë ditë nga data e marrjes në dorëzim.

4. Jo më vonë se pesë ditë nga ajo e nënshkrimit dhe dorëzimit nga kandidatët, dhe personat e lidhur të autorizimeve sipas pikës 2 të këtij neni:

a) Këshilli i dërgon ILDKPKI-së listën e kandidatëve që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit të Statusit;

b) relatori fillon procedurat për kryerjen e veprimeve të kërkit, nga organet e administratës tatimore e doganore, si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna mbi pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur.

5. Jo më vonë se 21 ditë nga dërgimi, në rrugë elektronike, i formularit të deklarimit të pasurisë, kandidati e dorëzon atë të plotësuar pranë ILDKPKI-së. Deklarimi bëhet sipas përcaktimeve të neneve 3/1, 4, pika 2 e vijues të ligjit nr. 9049/2003.

6. ILDKPKI-ja njofton menjëherë Këshillin në rastin kur kandidati nuk e dorëzon të plotësuar formularin e deklarimit të pasurisë.

7. ILDKPKI-ja kryen kontrollin e plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në "Deklaratën e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit" brenda dy muajve nga paraqitja e kësaj deklarate pranë ILDKPKI-së.

8. Nëse gjatë 180 ditëve para asaj të paraqitjes së deklaratës, kandidati i është nënshtruar kontrollit të plotë nga ILDKPKI-ja dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, kur ILDKPKI-ja vlerëson se nuk është vendi për rikontroll të plotë, sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 25/1, të ligjit nr. 9049/2003, atëherë kontrolli konsiderohet i kryer. ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Këshillit kopjen e deklarimit të bërë nga kandidati, si edhe gjetjet dhe përfundimet e këtij institucioni nga procedura e mëparshme e kontrollit të plotë të deklarimit. Në çdo rast, Këshilli kryen veprimet e parashikuara nga shkronja "b", e pikës 4 të këtij neni.

9. Pavarësisht parashikimit të pikës 7 të këtij neni, nëse pas fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatit, relatori vjen në dijeni, mbi informacionet dhe dokumentacionin e marrë nga burime të ligjshme (organet e administratës tatimore dhe doganore), për rrethana që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklarimin e pasurisë së kandidatit, njofton menjëherë ILDKPKI-në për të ushtruar kompetencën e rikontrollit të plotë të deklarimit të kandidatit, sipas parashikimeve neneve 3/1 dhe 25/1, pika 4, të ligjit nr. 9049/2003.

10. Në përfundim të verifikimit të kryer sipas ligjit, ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Këshillit raportin e kontrollit të plotë për pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur.

11. Relatori shqyrton rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, si edhe të dhënat mbi pasuritë, interesat privatë dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur, të dërguara nga subjektet publike sipas kërkesës së Këshillit.

12. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të pasurisë, relatori mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga ILDKPKI-ja, si dhe nga organet e administratës tatimore dhe doganore;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se pesë ditë nga ardhja dijeni, duhet të paraqesë këto shpjegime dhe dokumente mbështetëse drejtpërdrejtë pranë zyrës së posaçme të Këshillit. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin pesëditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i cakton kandidatit një afat



të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet, lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

13. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga organet e administratës tatimore dhe doganore, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin përjashtimin e kandidatit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë.

14. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga organet e administratës tatimore dhe doganore, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin përjashtimin e kandidatit, procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

15. Përjashtimi i kandidatit vendoset nga Këshilli, duke mbajtur parasysh rrethanat konkrete të rastit dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, në rastet kur të dhënat e marra nga burime të ligjshme tregojnë se:

a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij;

b) kandidati nuk ka deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat privatë, që janë të detyrueshme të deklarohen;

c) kandidati ka dhënë një deklaratë të rremë ose jo të saktë të aseteve;

ç) kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

16. Përjashtimi i kandidatit vendoset edhe në rastet kur kandidati:

a) nuk ka plotësuar ose depozituar pranë ILDKPKI-së formularin e deklaratës së pasurisë;

b) ka refuzuar ose nuk ka depozituar, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

Neni 18

Verifikimi i figurës dhe i integritetit të kandidatit

1. Jo më vonë se tre ditë nga vendimi i Këshillit për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore për ngritje në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës, kandidatit i dërgohen, në rrugë elektronike, formularët e mëposhtëm:

a) formulari i aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, sipas ligjit nr. 45/2015;

b) formulari i autorizimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, për t’i mundësuar Këshillit të kryejë verifikimin dhe të kërkojë raportim, informacion dhe dokumentacion nga institucionet kompetente për verifikimin e figurës: Byroja Kombëtare e Hetimit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe verifikimin lidhur me masa disiplinore në fuqi, me të dhëna mbi figurën dhe integritetin e tij.

2. Jo më vonë se pesë ditë nga dërgimi, në rrugë elektronike, i formularëve të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, kandidati i dorëzon ato të plotësuar në zyrën e posaçme të Këshillit.

3. Kandidatët që kanë marrë certifikatën e pastërtisë së figurës nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, nuk mbartin detyrimin për plotësimin dhe dorëzimin e formularit të aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, sipas ligjit nr. 45/2015, por duhet të dorëzojnë në zyrën e posaçme të Këshillit, certifikatën si më lart të pastërtisë së figurës nga institucionet përgjegjëse.

4. Struktura e posaçme pranë Këshillit kryen verifikimet e rastit për të dhënat e deklaruara nga kandidati dhe, kur është rasti, Kryetari i Këshillit përcjell formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015, të plotësuar nga kandidati, në Prokurorinë e Përgjithshme.



5. Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet sipas ligjit nr. 138/2015 dhe, mundësisht brenda dy muajve nga paraqitja e vetëdeklarimit pranë atij institucioni, i dërgon Këshillit raportin përkatës me përfundimet e procesit të verifikimit. Mosdërgimi në këtë afat i këtij raporti nga Prokuroria e Përgjithshme, nuk përbën shkak pengues të vijimit të procedurës së verifikimit të kushteve të ngritjes në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës, si dhe të pasurisë dhe figurës së atij kandidati.

6. Relatori i çështjes, jo më vonë se pesë ditë nga dorëzimi i vetëdeklarimit të kandidatit, në zyrën e posaçme të Këshillit, kryen edhe veprimet për kërkimin e informacionit mbi pengesat ligjore, sipas shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 11 të këtij neni, nga Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Shërbimi Informativ Shtetëror.

7. Formulari i aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” sipas nenit 29, të ligjit nr. 45/2015, i plotësuar vetëm nga kandidati i vitlindjes më të hershme se korrik 1977, i dërgohet menjëherë për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit. Mosdërgimi i informacionit nga ky Autoritet gjatë kohës së vazhdimit të procedurës së verifikimit të kandidatit nga Këshillit, nuk përbën shkak pengues për vijimin e verifikimit të kushteve të ngritjes në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës, si dhe të pasurisë dhe figurës për atë kandidat.

8. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të figurës dhe integritetit të kandidatit, relatori mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga institucionet e përmendura në këtë nen;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se pesë ditë nga ardhja dijeni, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetëse. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin pesëditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

9. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe gjetjet e përfundimet e nxjerra nga të dhënat e dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë nen, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të

sjellin përjashtimin e kandidatit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, për sa i përket verifikimit të figurës dhe integritetit të kandidatit.

10. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe të atyre të dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë nen, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin përjashtimin e kandidatit, procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, për sa i përket verifikimit të integritetit dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

11. Përjashtimi i kandidatit vendoset nga Këshilli në rastet kur nga raportet e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të institucioneve të tjera të përmendura në këtë nen, tregohet se kandidati:

a) ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

b) ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

c) ka qenë ose është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

12. Përjashtimi i kandidatit vendoset edhe kur kandidati:

a) nuk ka plotësuar ose depozituar formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” sipas ligjit nr. 45/2015;

b) ka refuzuar ose nuk ka depozituar, të nënshkruar, autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij.

Neni 19

Procedura e verifikimit të kushteve dhe kritereve për pasurinë, dhe figurën

1. Në procedurën e verifikimit, relatori i çështjes shqyrtton dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, formularët e deklarimeve të plotësuar, aktet e dërguara nga organet e ngarkuara me ligj për



kontrollin dhe verifikimin e deklarimeve të kandidatit, si edhe çdo akt, informacion dhe të dhënë tjetër të dërguar nga subjektet publike dhe private, me nismën e tyre ose mbi kërkesën e Këshillit apo që relatori i çështjes vlerëson se ka lidhje me gjykimin mbi plotësimin, ose jo të kushteve dhe kritereve për pasurinë dhe figurën për kandidim.

2. Relatori, bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit, nëse vlerëson paraprakisht që mund të procedohet me vendimin e kualifikimit ose të përjashtimit të kandidatit, pasi vë në dijeni Komisionin dhe me vendim të këtij të fundit, njofton kandidatin e verifikuar lidhur me gjetjet paraprake, si edhe për të drejtën që:

a) brenda një afati pesëditor nga dita e njoftimit, të paraqesë me shkrim, drejtpërdrejt pranë zyrës përkatëse të Këshillit ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit, si edhe të dokumentacionit mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të kandidatit;

b) të tërheqë, sipas rastit, kopje të dokumentacionit dhe të akteve të këtij procedimi administrativ ose të asaj pjese të tyre që lidhet me verifikimin e kushteve dhe kritereve përkatëse ligjore, për të cilat relatori ka vlerësuar paraprakisht se mund të sjellin përjashtimin e kandidimit.

3. Në pamundësi objektive ose për motive të tjera të justifikuara për të paraqitur qëndrimin dhe shpjegimet brenda afatit pesëditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin, duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i çështjes i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet, lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

4. Në rastin kur, në përfundim të afatit të njoftimeve sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, kandidati nuk paraqitet, nuk i përgjigjet njoftimeve të Këshillit, nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar ose nuk parashtron shpjegime me shkrim për gjetjet e procedurës së verifikimit, relatori i çështjes procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe problemet ligjore të konstatuara dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim përpara Komisionit.

5. Nëse në përfundim të këtyre procedurave administrative për verifikimin e kushteve dhe kritereve të pasurisë dhe figurës të kandidimit,

relatori i çështjes vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin përjashtimin e kandidatit, procedon me përgatitjen e çështjes dhe të relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit.

6. Nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të pasurisë ose figurës të kandidimit, relatori i çështjes procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm, dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim përpara Komisionit, pa qenë e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera verifikuese procedurale.

Neni 20

Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Komisioni

1. Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se pesë ditë nga ajo e njoftimit të Kryetarit të Komisionit.

2. Në mbledhjen e Komisionit, Kryetari fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e procedurave, të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurave për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve të pasurisë, dhe figurës nga kandidati i verifikuar.

3. Komisioni, pasi dëgjon paraprakisht diskutimin e relatorit të çështjes, bisedon dhe vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill nëse procedurat e verifikimit janë të plota ose i kërkon relatorit të çështjes vijimin e procedurës së verifikimit, duke evidentuar dhe çështjet që kanë nevojë të verifikohen më tej.

4. Relatori i çështjes ka detyrimin të kryejë verifikimet e evidentuara nga Komisioni, në përfundim të të cilave njofton Kryetarin e Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, duke vijuar procesi më pas, sipas pikave 1 deri 3 të këtij neni.

Neni 21

Tërheqja e kandidatit nga procedura e verifikimit

1. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që



përshtkruan ecurinë e procedurës së zhvilluar deri në momentin e tërheqjes, si dhe projektaktin për përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit të tërhequr.

2. Relacioni dhe projektakti i përcillen menjëherë për shqyrtim Komisionit, i cili vendos përfundimin e procedurës së verifikimit pa vendim përfundimtar.

3. Kundër vendimit të Komisionit, kandidati ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rishikim pranë Mbledhjes Plenare të Këshillit, brenda 10 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 191, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Neni 22

Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Këshilli

1. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga Kryetari i Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga ajo e njoftimit të Kryetarit të Komisionit.

2. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori i çështjes, i njoftohet kandidatit. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Në mbledhjen e Këshillit, Kryetari i Këshillit fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e procedurave, të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurave për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve të pasurisë, dhe figurës nga kandidati i verifikuar.

4. Në përfundim të parashtrimeve të relatorit të çështjes, nëse vlerësojnë, anëtarët e Këshillit mund t'i drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

5. Nëse anëtarët e Këshillit nuk parashtrojnë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit të çështjes, Këshilli deklaron kalimin në fazën e bisedimit, votimit dhe të dhënies së vendimit.

6. Këshilli, pasi dëgjon paraprakisht diskutimin e relatorit të çështjes, bisedon dhe vendos për të gjitha çështjet që parashtrohen në relacionin e përgatitur prej tij ose që vlerësohen nga anëtarët.

7. Në përfundim të bisedimeve, për zgjidhjen e çështjes, i pari voton relatori i çështjes, i pasuar nga

anëtarët e Komisionit, me tej anëtarët e tjerë të Këshillit dhe në fund Kryetari i Këshillit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

8. Në çdo rast, vendimi i Këshillit arsyetohet jo më vonë se 5 ditë nga ajo e shpalljes.

9. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Anëtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin.

10. Përveç rastit kur ka mbetur në pakicë, arsyetimi i vendimit të Këshillit bëhet nga relatori i çështjes. Anëtari që ka mbetur në pakicë, mund të arsyetojë qëndrimin e tij, i cili i bashkohet vendimit.

11. Këshilli, ose secili anëtar i tij nëse pas shqyrtimit të relacionit dhe të akteve bashkëlidhur konstaton gjetje, materiale me gjetjet dhe motivit të cilat mund të bëhen shkas për përjashtimin nga kandidimi, i njofton kandidatit. Kandidati ka të drejtën e parashtrimit me shkrim të shpjegimeve të tij dhe dokumenteve mbështetëse, jo më vonë se pesë ditë nga ajo e ardhjes në dijeni të materialit të dërguar nga Këshilli. Këshilli cakton një seancë tjetër për shqyrtimin e çështjes.

12. Pas bisedimit dhe votimit të çështjes, Këshilli vendos kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës për ngritjen në detyrë në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose përjashtimin e kandidatit nga procedura e ngritjes në detyrë.

13. Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nëse ai nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e pasurisë dhe figurës të kandidimit, duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë:

a) deklarimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga vetë kandidati;

b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si edhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit.

14. Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit edhe në rastet kur, pas njoftimeve të Këshillit, gjatë procedurës së verifikimit, kandidati përsëri nuk i përmbush detyrimet për paraqitjen ose plotësimin e deklaratave, autorizimeve dhe të dokumentacionit, lidhur me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit të parashikuara nga ligji.



Neni 23

Vendimi i verifikimit dhe e drejta e ankimit

1. Vendimi i verifikimit arsyetohet sipas kërkesave të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ.

2. Vendimi i verifikimit njoftohet sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit të Statusit dhe bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimitetit të subjekteve.

3. Ndaj vendimit të përjashtimit të Këshillit për procedurën e verifikimit, kandidati mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda pesë ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Neni 24

Publikimi i akteve të procedurës së verifikimit

1. Vendimet e Këshillit për verifikimin e kandidaturave bëhen publike në faqen zyrtare.

2. Në faqen zyrtare të Këshillit publikohen edhe:

a) lista e kandidatëve për të cilët është vendosur kualifikimi për ngritje në detyrë në pozicion e kryetarit të gjykatës;

b) lista e kandidatëve për të cilët është vendosur përjashtimi nga procedura e ngritjes në detyrë në pozicion e kryetarit të gjykatës.

PJESA III

PROCEDURA E PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN NË DETYRË

KREU I

RENDITJA E KANDIDATËVE DHE PËRCAKTIMI I PËRPARËSIVE

Neni 25

Renditja e kandidatëve

1. Renditja e kandidatëve kryhet me qëllim caktimin në funksionin e kryetarit të kandidatit më të mirë të listuar.

2. Procesi i renditjes zhvillohet deri në tre hapa vlerësimi, në secilin prej të cilëve kryhet një vlerësim krahasues i treguesve që lidhen me kriteret dhe përparësitë e përcaktuara e të renditura në nenin 52,

pika 10, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, si dhe të detajuara në këtë vendim.

3. Hapi pasues i procesit të renditjes ndiqet vetëm në rast se, pas përfundimit të hapit paraardhës, nuk është e mundur të përcaktohet renditja përfundimtare e kandidatëve për shkak të rezultateve të njëjta më të larta.

Neni 26

Renditja sipas dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale

1. Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart.

2. Në rastin e kandidatit të komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë, niveli i vlerësimit etik dhe profesional nga ky institucion, njihet si nivel vlerësimi edhe në kuptim të kësaj rregulloreje, duke mbajtur në konsideratë në këtë rast nivelet e vlerësimit sipas ligjit të posaçëm të institucionit të sistemit të drejtësisë dhe nivelet e vlerësimit sipas sistemit të kohës për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve.

3. Në rastin kur kandidatit të komanduar nuk i është bërë vlerësim etik dhe profesional nga institucioni në të cilin gjyqtari është komanduar, ai ka të drejtë të vlerësohet për aftësitë profesionale si kandidat jogjyqtar për në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49 të Ligjit të Statusit dhe vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimit nr. 102, datë 5.7.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe vendimit nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, për aq sa gjejnë zbatim, me qëllim që të konkurrojnë në kushte të njëjta me magjistratët e tjerë për pozicionin e lirë.

Neni 27

Renditja sipas skemës së pikëzimit

1. Në rast se, pas përfundimit të vlerësimit të bërë sipas nenit 26 të kësaj rregulloreje, rezulton se më shumë se një kandidat ka të njëjtin nivel vlerësimi, renditja e tyre përcaktohet duke zbatuar skemën e



pikëzimit, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje dhe aneksit 1.

2. Skema e pikëzimit zbatohet në mënyrë të veçantë për çdo procedurë të ngritjes në detyrë dhe vlen vetëm për kandidatët që marrin pjesë në të njëjtën procedurë konkurrimi për pozicionin e kryetarit të gjykatës.

3. Kriteret e skemës së pikëzimit përfshihen në aneksin 1, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

4. Skema e vlerësimit, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, bazohet në analizën krahasuese dhe cilësore të nivelit të kriterëve përbërëse të vlerësimit, sipas përcaktimeve të aneksit 1.

Neni 28

Kriteret e skemës së pikëzimit

1. Me qëllim vlerësimit dhe pikëzimit të aftësive organizative dhe drejtuese të kandidatit për pozicionin e kryetarit të gjykatës, vlerësuesi bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) Aftësitë organizative dhe drejtuese, të cilat përbëhen nga:

i. përvoja si zëvendëskryetar gjykate, kryetar i një seksioni dhe/ose gjyqtar për çështjet me shtypin;

ii. përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, si dhe përvoja si anëtar i Këshillit, që ka përfunduar të paktën tre vjet më parë;

iii. përvoja në aktivitet bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me organe të tjera kushtetuese, administratën publike dhe organizata ndërkombëtare;

iv. përvoja si magjistratë në skemën e delegimit ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

v. ngarkesa mesatare e kandidatit për tri vitet e fundit gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor, në raport me ngarkesën mesatare të gjykatës ku ushtron funksionin;

b) Aftësitë në hartimin e akteve administrative, të cilat përbëhen nga:

i. kontributi në hartimin e akteve administrative të gjykatës;

ii. kontributi në hartimin e projektakte ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë;

iii. kontributi në grupet e punës për përgatitjen e udhëzimeve, rregulloreve apo akteve nënligjore në sistemin gjyqësor;

iv. pjesëmarrja në komisione ose këshilla që kanë pasur për objekt hartimin ose shqyrtimin e akteve administrative;

c) Aftësitë në komunikim, të cilat përbëhen nga:

i. qartësia dhe struktura e komunikimit;

ii. dëgjim aktiv dhe bashkëbisedim;

iii. komunikimi institucional;

iv. komunikimi i brendshëm;

ç) Aftësi të tjera profesionale, menaxheriale dhe organizimi përbëhen nga:

i. angazhimi si ekspert ose lehtësues në Shkollën e Magjistraturës, në trajnime ose module që trajtojnë temat e menaxhimit të gjykatave, drejtimit institucional dhe zhvillimit të lidershipit gjyqësor;

ii. mbajtja e gradës shkencore, titujve akademikë, ndjekja e studimeve ose specializimeve afatgjata, brenda ose jashtë vendit, që kanë lidhje me fushën e lidershipit dhe menaxhimit gjyqësor;

iii. pjesëmarrje si ekspert në trajnime kombëtare ose ndërkombëtare, jashtë programit të doktoraturës, në fushën e menaxhimit dhe drejtimit të gjykatave, pjesëmarrja në konferenca gjyqësore me fokus zhvillimin e lidershipit në sistemin gjyqësor;

iv. si dhe zotërimi i një prej gjuhëve zyrtare të Bashkimit Evropian;

d) Vizioni për drejtimin e një gjykate funksionale dhe efektive përbëhet nga:

i. plani për mënyrën e ushtrimit të kompetencave të kryetarit të gjykatës;

ii. plani për drejtimin, zhvillimin institucional dhe rritjen e efektivitetit;

iii. plani për organizimin dhe funksionimin e gjykatës;

iv. vlerësimi i situatës aktuale dhe vizioni për përmirësim;

v. masat për rritjen e besueshmërisë publike në sistemin gjyqësor;

vi. evidentimi dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore në veprimtarinë gjyqësore.

Neni 29

Treguesit për vlerësimin e kriterëve të skemës së pikëzimit

1. Vlerësimi i aftësive organizative dhe drejtuese të kandidatit për pozicionin e kryetarit të gjykatës bazohet në një analizë krahasuese të përvojës që ka çdo kandidat në ushtrimin e funksioneve drejtuese në sistemin gjyqësor, si zëvendëskryetar gjykate,



kryetari i një seksioni, dhe/ose gjyqtar për çështjet me shtypin, përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose në sistemin e drejtësisë, përvoja si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, e përfunduar të paktën tre vjet më parë; përvoja në aktivitete bashkëpunimi të caktuar ose vullnetarisht me Këshillin, me organe të tjera kushtetuese, administratën publike dhe organizatat ndërkombëtare; njohuritë dhe përvoja në strukturat organizative dhe në modelet e drejtimit të institucioneve gjyqësore, përfshirë përvojën si magjistrat në skemën e delegimit ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në procesin e vlerësimit merret, gjithashtu, në konsideratë ngarkesa e kandidatit gjatë tri viteve të fundit të ushtrimit të funksionit gjyqësor, si tregues i aftësisë për të menaxhuar në mënyrë efektive volumin e çështjeve të caktuara dhe të përfunduara, në raport me ngarkesën mesatare të gjykatës ku ai ushtron funksionin.

2. Vlerësimi i aftësive në hartimin e akteve administrative bazohet në të dhëna të dokumentuara që pasqyrojnë angazhimin dhe rolin e kandidatit në hartimin e akteve administrative të gjykatës, kontributin në hartimin e projektakteve ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë, kontributin në grupe pune për përgatitjen e udhëzimeve, rregulloreve apo akteve nënligjore në sistemin gjyqësor, si dhe në pjesëmarrjen në komisione ose këshilla që kanë pasur për objekt hartimin ose shqyrtimin e akteve administrative.

3. Vlerësimi i aftësive të komunikimit të kandidatit bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse të mënyrës se si ai shpreh mendimet, ndërvepron dhe përfaqëson institucionin në ushtrimin e funksionit gjyqësor dhe në marrëdhëniet institucionale. Treguesit e këtij kriteri përfshijnë **qartësinë dhe strukturën e komunikimit**, që lidhet me aftësinë për të shprehur mendimet qartë, me gjuhë të kuptueshme dhe të saktë; **aftësinë për dëgjim aktiv dhe bashkëbisedim konstruktiv**, që pasqyron respektimin e mendimeve të të tjerëve dhe reagimin reflektues ndaj sugjerimeve apo kritikave; **aftësinë për komunikim institucional**, që vlerëson mënyrën e përfaqësimit me dinjitet dhe profesionalizëm të gjykatës në raport me institucionet e tjera, duke ruajtur etikën dhe koherencën në komunikimet zyrtare; **aftësinë për komunikim të brendshëm**, që lidhet me ndërtimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me gjyqtarët dhe

stafin administrativ, për të krijuar një atmosferë bashkëpunuese, për të përcjellë udhëzime të qarta dhe për të zgjidhur keqkuptimet përmes dialogut.

4. Vlerësimi i aftësive të tjera profesionale, menaxheriale dhe organizmi, bazohet në analizën e angazhimit të kandidatit si ekspert ose lehtësues në Shkollën e Magjistraturës, në trajnime ose module që trajtojnë temat e menaxhimit të gjykatave, drejtimit institucional dhe lidhshirësisë gjyqësore; mbajtja e gradës shkencore, titujve akademikë, ndjekja e studimeve ose specializimeve afatgjata brenda ose jashtë vendit, që lidhen me zhvillimin e lidhshirësisë dhe menaxhimit gjyqësor; pjesëmarrja si ekspert në trajnime kombëtare ose ndërkombëtare, jashtë programit të doktoraturës, në fushën e menaxhimit dhe drejtimit të gjykatave, pjesëmarrja në konferenca gjyqësore me fokus zhvillimin e lidhshirësisë në sistemin gjyqësor; si dhe zotërimi i një prej gjuhëve zyrtare të Bashkimit Evropian, që ndihmon në zgjerimin e kompetencave dhe aftësive ndërkulturore të kandidatit.

5. Vlerësimi i vizionit për drejtimin e një gjykate funksionale dhe efektive bazohet në platformën e paraqitur nga kandidati, duke i kushtuar rëndësi nivelit të kuptimit që ai ka për rolin dhe përgjegjësitë e kryetarit të gjykatës, vizionit të tij në lidhje me sfidat kryesore me të cilat përballlet gjykata nga pikëpamja organizative, administrative dhe e funksionimit, si dhe mendimeve dhe propozimeve të paraqitura për adresimin e këtyre sfidave. Në procesin e vlerësimit merren parasysh, gjithashtu, qartësia, koherenca, struktura dhe cilësia e gjuhës së përdorur në dokument.

6. Kandidati ka detyrimin të paraqesë dokumentet që shërbejnë për vlerësimin e kriterëve të përcaktuara në këtë nen, si dhe çdo provë tjetër që mbështet vlerësimin e aftësive të tij profesionale, organizative dhe drejtuese.

Neni 30

Vlerësimi dhe pikëzimi

1. Përcaktimi i treguesve për secilin kriter vlerësimi, si dhe pesha specifike e tyre, bëhet në skemën e pikëzimit, aneksi 1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

2. Niveli i vlerësimit për secilin prej kriterëve të skemës së vlerësimit përcaktohet mbi bazën e një shkallë pikëzimi nga 1 deri në 100 pikë.



3. Në skemën e pikëzimit përcaktohen ndarja e kriterëve të vlerësimit, aspektet përbërëse të secilit kriter, treguesit e vlerësimit, burimet e vlerësimit dhe pikëzimi përkatës i tyre, në funksion të përcaktimit të rezultatit përfundimtar të kandidatit për pozicionin e kryetarit të gjykatës.

Neni 31 Vlerësimi i kandidatëve

1. Relatori harton aktin paraprak ku përshkruan burimet e vlerësimit, të dhënat e grumbulluara gjatë fazës verifikuese dhe procedurale, si dhe çdo informacion mbështetës që shërben për vlerësimin lidhur me katër kriteret e para të vlerësimit sipas skemës së pikëzimit, duke përjashtuar kriterin që lidhet me vizionin për drejtimin e gjykatës. Për zhvillimin dhe miratimin e këtij procesi ndiqet procedura e përcaktuar në nenin 41 të kësaj rregulloreje.

2. Këshilli njofton kandidatët për zhvillimin e intervistës dhe, pas përfundimit të saj, kryen vlerësimin përfundimtar me pikë për të pesë kriteret e vlerësimit, duke miratuar renditjen përfundimtare të kandidatëve.

3. Për kriterin e pestë, që lidhet me vizionin për drejtimin e një gjykate funksionale dhe efektive, pas zhvillimit të intervistës me kandidatin, vlerësohen gjashtë tregues, secili me peshë të barabartë deri në 5 pikë. Ky kriter ka një vlerësim maksimal prej 30 pikësh dhe zbatohet në përputhje me përcaktimet e aneksit 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 32 Renditja sipas përvojës profesionale specifike

1. Në rast se pas vlerësimit të bërë ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, renditja e kandidatëve bazohet në përvojën profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë.

2. Përvoja profesionale specifike përfshijnë ushtrimin e funksioneve si zëvendëskryetar, kryetar seksioni, gjyqtar i medias, përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose në sistemin e drejtësisë, përvoja si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, përvoja si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

3. Kandidati që ka ushtruar një ose më shumë nga këto përvoja profesionale specifike renditet më lart, sipas përparësive të mëposhtme:

a) “Kohëzgjatja e përvojës” – sipas kësaj përparësie, kandidati me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;

b) “Shumëllojshmëria e përvojave” – sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.

Neni 33 Renditja sipas vjetërsisë si gjyqtar

1. Në rast se pas vlerësimit të bërë sipas nenit 32 të kësaj rregulloreje, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si gjyqtar. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart.

2. Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si jurist. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart.

KREU II RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES

Neni 34 Fillimi i procedurës dhe caktimi i relatorit

1. Këshilli, jo më vonë së 7 ditë nga vendimi i parë për kualifikimin e një kandidati, vendos fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrën e kryetarit, si dhe cakton, nëpërmjet shortit, relatorin për atë procedurë. Për arsye të motivuara, mbi kërkesën e çdo anëtarit të Komisionit, Këshilli mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti.

2. Përjashtimisht, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi propozimin e Komisionit, Këshilli mund të vendosë që në procedurat e shortit për caktimin e relatorit, në një ose disa procedura përzgjedhjeje për ngritjen në detyrën e kryetarit, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.

3. Anëtarit i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, në çdo kohë kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, sipas neneve 72, 73, 74 dhe 75 të Ligjit për



Qeverisjen, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë.

4. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, që më herët ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar në një procedurë verifikimi të kriterëve ligjore të kandidimit, të pasurisë dhe të figurës për një nga kandidatët që konkurron për pozicionin e lirë për të cilin zhvillohet procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrën e kryetarit, nuk mund të marrë pjesë në këtë procedurë në rast se konflikti i interesit ose pengesa ligjore për shkak të të cilit ai ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar, vijon të ekzistojë.

5. Për dorëheqjen e çdo anëtari të Këshillit vendos Kryetari i tij. Kur dorëheqjen e jep Kryetari i Këshillit, vendimi merret nga Zëvendëskryetari i tij.

Neni 35

Të drejtat e kandidatit

1. Kandidati njoftohet për relatorin menjëherë me fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës.

2. Kandidati ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e relatorit për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75 të Ligjit për Qeverisjen, jo më vonë se 3 ditë, nga marrja dijeni e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtari tjetër të Këshillit.

3. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e relatorit të çështjes dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e saj.

4. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrën e kryetarit, me kërkesë, të njihet me dokumentet e dosjes së tij, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative.

5. Kandidati, që ka qenë i komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë dhe ky i fundit nuk ka bërë vlerësimin e tij etik dhe profesional, ka të drejtë që, në momentin e aplikimit për ngritjen në detyrë, të kërkojë bërjen e këtij vlerësimi nga Këshilli sipas rregullave përkatëse të vlerësimit.

6. Kryesisht, apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për fakte, rrethana apo çështje ligjore që lidhen me kriteret e renditjes, si dhe të depozitojë, kur është rasti, dokumente shkresore në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

7. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrën e kryetarit, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim. Mbi këtë kërkesë, me propozim të relatorit të çështjes, Komisioni vendos përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Vendimi i Komisionit i njoftohet kandidatit dhe bëhet publik në faqen e tij zyrtare.

Neni 36

Afatet dhe llogaritja e tyre

1. Afatet në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës caktohen në ditë kalendarike.

2. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligj ose në këtë rregullore, në llogaritjen e afatit përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

3. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

4. Dita e fundit e afatit vazhdon deri në orën 24:00 të saj. Afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa, shpjegimet ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.

Neni 37

Njoftimet

1. Njoftimet dhe kërkesat e Këshillit drejtuar kandidatit dhe anasjelltas, si rregull bëhen në rrugë elektronike. Ato konsiderohen të marra ditën e nesërme të dërgimit në rrugë elektronike.

2. Adresa elektronike e Këshillit i bëhet e ditur kandidatit me njoftimin e fillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrën e kryetarit.

3. Adresë elektronike e kandidatit konsiderohet adresa zyrtare e tij, por ai mund të zgjedhë një adresë tjetër elektronike, duke ia bërë atë të ditur në kohë



Këshillit. Kandidati merr masa për aksesueshmërinë e adresës së tij elektronike.

KREU III
FAZAT E PROCEDURËS SË
PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN NË
DETYRËN E KRYETARIT

Neni 38

Fazat e përzgjedhjes së kandidatëve

1. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës realizohet në tre faza:

a) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit, përfshirë, kur është rasti, edhe ato për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit që ka qenë i komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë dhe ky i fundit nuk ka bërë vlerësimin e tij etik dhe profesional;

b) shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit të renditjes së kandidatëve;

c) shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit të renditjes së kandidatëve.

Neni 39

Veprimet procedurale dhe verifikuese
të relatorit

1. Procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës zhvillohet paralelisht:

a) me procedurat e verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit, të pasurisë dhe të figurës për kandidatët e tjerë që konkurrojnë për atë pozicion të lirë.

b) me procedurat e vlerësimit dhe pikëzimit për kandidatët e tjerë që konkurrojnë për atë pozicion të lirë, të cilët kanë qenë të komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë dhe ky i fundit nuk ka bërë vlerësimin e tyre etik dhe profesional.

2. Vetëm kandidatët e kualifikuar dhe që kanë dy vlerësime etike dhe profesionale bëhen pjesë e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë.

3. Relatori kujdeset për zhvillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për ngritjen në detyrë dhe në veçanti për:

a) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve, që gjenden në

dosjen e tyre personale apo që paraqitet nga ata gjatë procedurës së përzgjedhjes;

b) përgatitjen e relacionit që përmban përshkrimin e veprimeve të kryera dhe të dokumenteve të administruara gjatë procedurës së përzgjedhjes, si dhe një përmbledhje faktike të tyre për atë sa është e nevojshme për renditjen e kandidatëve, duke i bashkëlidhur atij kopje të këtyre dokumenteve;

c) përgatitjen e projektvendimit të renditjes së kandidatëve;

ç) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;

d) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;

dh) njoftimet për kandidatët.

4. Relatori i çështjes ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisionit dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit.

5. Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” mbi paanësinë e administratës publike zbatohen edhe për nëpunësit e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve dhe personelin administrativ të Këshillit.

6. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes personale, relatori i çështjes vlerëson se ka mangësi, njofton menjëherë kandidatin, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë, për të dhënë sqarime ose për të plotësuar mangësitë. Mungesa e përgjigjes së kandidatit nuk pengon vijimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë.

7. Kur është rasti, relatori mund të kërkojë nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sqarime, të dhëna ose kopje të dokumenteve të konfirmuara zyrtarisht prej tyre.

8. Në përfundim të veprimeve për të gjithë kandidatët në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në pozicion të lirë të kryetarit të gjykatës, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe projektvendimin për renditjen e kandidatëve.



Neni 40

Shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit të renditjes së kandidatëve

1. Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke marrë masa për njohjen e anëtarëve me materialet e çështjes.

2. Në mbledhjen e Komisionit, relatori paraqet përmbledhjen e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë të kandidatëve.

3. Komisioni, pasi dëgjon relatorin, nëse vlerëson që procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe dokumentacioni përkatës i kandidatëve është i paplotë, i kërkon relatorit plotësimin e procedurës apo të dokumentacionit të nevojshëm, duke evidentuar sipas rastit veprimet procedurale dhe/ose dokumentacionin, për të cilët lind nevoja e plotësimit apo saktësimit. Në rast të kundërt, Komisioni vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill.

Neni 41

Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit të renditjes së kandidatëve

1. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes.

2. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i njoftohet kandidatëve. Ky njoftim publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Në mbledhjen e Këshillit, Kryetari fton relatorin të paraqesë përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë të kandidatëve për pozicionin e lirë të kryetarit të gjykatës.

4. Në përfundim të parashtrimeve të relatorit, nëse vlerësojnë, anëtarët e Këshillit mund t'i drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

5. Nëse anëtarët nuk parashtrojnë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit të çështjes, Këshilli kalon në fazën e bisedimit dhe vendos për këto çështje, sipas rendit të mëposhtëm:

a) plotësinë e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori dhe plotësinë e dokumentacionit të nevojshëm për renditjen e kandidatëve;

b) miratimin e projektvendimit paraprak të vlerësimit;

c) miratimin e listës me kandidatët të kualifikuar;

ç) përcaktimin e kalendarit të intervistave me kandidatët e kualifikuar.

6. Në përfundim të bisedimeve, Këshilli kalon në votim për secilën nga çështjet e renditura në pikën 5 të këtij neni, ku i pari voton relatori i çështjes, i pasuar nga anëtarët e Komisionit, më tej anëtarët e tjerë të Këshillit dhe në fund Kryetari i Këshillit. Në përfundim të votimit, Kryetari deklaron rezultatin e votimit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

7. Nëse gjatë bisedimeve Këshilli vlerëson dhe vendos që veprimet procedurale të kryera nga relatori dhe/ose dokumentacioni i nevojshëm për renditjen e kandidatëve nuk është i plotë, atëherë nuk vijon me bisedimin e projektvendimit të renditjes së kandidatëve, por cakton një seancë tjetër për shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast, Këshilli ngarkon relatorin të marrë masa për plotësimin sa më parë të mangësive të evidentuara. Në seancën e radhës, që caktohet jo më vonë se 7 ditë nga njoftimi i relatorit, ky i fundit paraqet para Këshillit aktet shtesë. Në këtë rast, Këshilli vijon bisedimet dhe vendos për çështjet e renditura në pikën 5 të këtij neni.

Neni 42

Intervista dhe seanca dëgjimore me kandidatët e kualifikuar

1. Kandidatët e kualifikuar njoftohen për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të intervistës, e cila realizohet në seancë dëgjimore gjatë mbledhjes së Këshillit. Njoftimi përmban edhe udhëzime të detajuara lidhur me natyrën dhe kohëzgjatjen e intervistës.

2. Gjatë seancës dëgjimore, Këshilli zhvillon pyetje me kandidatët e kualifikuar, me qëllim marrjen e informacionit shtesë mbi platformën e paraqitur prej tyre, si dhe për të vlerësuar vizionin, objektivat dhe përshtatshmërinë e tyre për pozicionin e shpallur të lirë.

3. Këshilli thërret individualisht secilin nga kandidatët për zhvillimin e intervistës.



4. Pas orientimit fillestar mbi mënyrën e zhvillimit dhe kohëzgjatjen e intervistës, kandidati ftohet të paraqesë platformën e tij, arsyet e kandidimit dhe objektivat që synon të ndjekë në rast emërimi në pozicionin e kryetarit të gjykatës. Intervista vijon me pyetjet e anëtarëve të Këshillit dhe përgjigjet përkatëse të kandidatit.

5. Pas përfundimit të seancës dëgjimore, Këshilli vijon me shqyrtimin e çështjes dhe vendos në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 43

Procedura e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve

1. Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatëve kryhet në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në ligj, si dhe sipas rregullave të detajuara në këtë rregullore dhe në aneksin e skemës së pikëzimit. Ky vlerësim mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe, kur është rasti, edhe në intervistat e realizuara me kandidatët.

2. Çdo anëtar i Këshillit vlerëson dhe pikëzon me shkrim meritat e secilit kandidat, në formë tabelore. Relatori paraqet i pari arsyetimin mbi vlerësimin e meritave dhe depoziton pikëzimin për çdo kriter, më pas nga anëtarët e tjerë të Këshillit dhe në fund nga Kryetari i Këshillit.

3. Këshilli shqyrton dhe vendos për vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat, mbi bazën e projektvendimit përfundimtar të përgatitur nga relatori i çështjes. Në projektvendim pasqyrohen pikët për secilin kriter, totali i pikëve dhe arsyetimi për vlerësimin e dhënë për secilin kriter.

4. Rezultati i pikëzimit për secilin prej kriterëve, për çdo kandidat, rezulton nga pjesëtimi i shumës së pikëve totale të caktuara nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në procedurën e përzgjedhjes me numrin e këtyre të fundit.

5. Këshilli, pasi verifikon saktësinë e projektvendimit të vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat, e miraton atë.

6. Pas përfundimit të vlerësimit dhe pikëzimit, Këshilli vijon me renditjen e kandidatëve, mbi bazën e projektvendimit të renditjes, të përgatitur nga relatori i çështjes dhe të miratuar paraprakisht nga Komisioni.

7. Renditja e kandidatëve bëhet sipas rezultatit përfundimtar të pikëzimit të secilit prej tyre.

8. Në rast të rezultateve të njëjta të pikëve mes kandidatëve, renditja përcaktohet në bazë të përvojës profesionale specifike të kërkuar për pozicionin e lirë, sipas nenit 32 të kësaj rregulloreje. Në rast se edhe pas kësaj ka barazi mes kandidatëve, renditja e tyre përcaktohet në bazë të nenit 33 të kësaj rregulloreje.

9. Këshilli, pasi verifikon saktësinë e projektvendimit të renditjes së kandidatëve, e miraton atë.

Neni 44

Vendimi për renditjen e kandidatëve

1. Vendimi i Këshillit për renditjen e kandidatëve arsyetohet nga relatori, jo më vonë se 10 ditë nga miratimi, duke reflektuar çdo sugjerim për të cilin kanë rënë dakord shumica e anëtarëve të Këshillit. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në votim.

2. Vendimi i arsyetuar i Këshillit iu njoftohet kandidatëve.

3. Kundër vendimit të Këshillit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit. Gjykata merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

4. Në rastin kur Gjykata Administrative e Apelit pranon ankimin e kandidatit/kandidatëve dhe shfuqizon vendimin, Këshilli, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

5. Vendimi i formës së prerë për renditjen e kandidatëve bëhen publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

KREU IV

NGRITJA NË DETYRËN E KRYETARIT TË GJYKATËS

Neni 45

Vendimi për ngritjen në detyrë

1. Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë, mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori i asaj



procedure, Këshilli merr vendim për ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës të kandidatit të renditur më lart.

2. Vendim i Këshillit për ngritjen në detyrë i njoftohet kandidatit të ngritur në detyrë, gjykatës respektive, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

PJESA IV PROCEDURA TË TJERA

KREU I PROCEDURA E RIEMËRIMIT NË DETYRËN E KRYETARIT TË GJYKATËS

Neni 46 Kërkesa për riemërim

1. Mandati i kryetarit të gjykatës është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Kryetari i gjykatës mund të kandidojë për një mandat të dytë jo më vonë se 6 muaj para mbarimit të mandatit të parë. Në rast se nuk kandidon brenda këtij afati, ai konsiderohet se ka dhënë dorëheqjen nga detyra në përfundim të mandatit.

Neni 47 Verifikimi dhe riemërimi i kryetarit

1. Kur kryetari në detyrë kandidon për riemërim për një mandat tjetër, ai i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli, jo më vonë se tre muaj para mbarimit të mandatit të parë, sipas rregullave të përcaktuara në pikat 2–7, të nenit 32, të Ligji për Statusin dhe rregullave të parashikuara në këtë vendim.

2. Kryetari mund të riemërohet për një mandat tjetër vetëm nëse:

a) kalon me sukses verifikimin e pasurisë dhe figurës;

b) vlerësimi i veprimtarisë së tij si kryetar dhe magjistrat është të paktën “shumë mirë”.

3. Këshilli merr vendim mbi riemërimin e kryetarit jo më vonë se tre muaj pas mbarimit të mandatit të tij.

Neni 48 Ushtrimi i kompetencave të Kryetarit nga Zëvendëskryetari

1. Në rast se nuk ka kandidatë për vendin e lirë për pozicionin e kryetarit të gjykatës zëvendëskryetari i gjykatës ushtron përkohësisht kompetencat e kryetarit.

2. Në rast se periudha midis përfundimit të mandatit të parë dhe emërimit/riemërimit të kryetarit zgjat tej afateve të përcaktuara, zëvendëskryetari do të ushtrojë përkohësisht kompetencat e kryetarit. Kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se tre muaj.

3. Zëvendëskryetari i gjykatës ushtron përkohësisht kompetencat e kryetarit në çdo rast tjetër kur pozicioni i kryetarit mbetet përkohësisht i lirë për arsye të tjera të parashikuara në ligj.

Neni 49 Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

ANEKS 1

SKEMA DHE METODOLOGJIA E PIKËZIMIT TË KANDIDATIT PËR POZICIONIN E KRYETARIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DHE TË DYTË

A.AFTËSITË ORGANIZATIVE DHE DREJTUESE (40 pikë)			Pikët total
Treguesit	Burimet	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
A.1 Përvoja si zëvendëskryetar gjykatë, kryetar seksioni dhe/ose gjyqtar për çështjet me shtypin	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		Koha efektive e ushtrimit të funksionit vlerësohet me 3 pikë për çdo vit gjyqësor të plotë ushtrimi të detyrës, por jo më shumë se 9 pikë në total. Në rastet kur periudha e ushtrimit të funksionit nuk përkon



			plotësisht me një vit kalendarik, vlerësimi kryhet në mënyrë proporcionale, në përpjesëtim me kohëzgjatjen e ushtrimit të detyrës.
A.2 Përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose në sistemin e drejtësisë, si dhe përvoja si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		Koha efektive e ushtrimit të funksioneve vlerësohet me 3 pikë për çdo vit gjyqësor të plotë ushtrimi të detyrës, por jo më shumë se 15 pikë. Në rastet kur periudha e ushtrimit të funksionit nuk përkon plotësisht me një vit kalendarik, vlerësimi kryhet në mënyrë proporcionale, në përpjesëtim me kohëzgjatjen e ushtrimit të detyrës.
A.3 Përvoja në aktivitete bashkëpunimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me organe të tjera kushtetuese, administratën publike dhe organizatat ndërkombëtare	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		Kontributet e dokumentuara në kuadër të aktiviteteve të bashkëpunimit të caktuar apo vullnetarisht me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me institucione të tjera kushtetuese, me administratën publike dhe/ose me organizata ndërkombëtare, të cilat dëshmojnë aftësi në drejtim, koordinim apo menaxhim institucional të sistemit gjyqësor, vlerësohen me 1.5 pikë për çdo aktivitet ose kontribut të veçantë, në varësi të rëndësisë, qëndrueshmërisë dhe ndikimit profesional. Në total, ky tregues nuk mund të kalojë 3 pikë.
A.4 Përvoja si magjistratë në skemën e delegimit ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		Koha efektive e ushtrimit të funksionit si magjistrat në skemën e delegimit ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vlerësohet deri në 1 pikë për çdo vit të plotë ushtrimi të detyrës, por jo më shumë se 10 pikë. Në rastet kur periudha e ushtrimit të funksionit nuk përkon plotësisht me një vit kalendarik, vlerësimi kryhet në mënyrë proporcionale, në përpjesëtim me kohëzgjatjen e ushtrimit të detyrës.
A.5 Ngarkesa mesatare e kandidatit për tri vitet e fundit gjatë ushtrimit të funksionit gjyqësor, në raport me ngarkesën mesatare të gjykatës ku ushtron funksionin	1. Të dhënat statistikore të administruara nga Këshilli dhe të raportuara nga gjykatat për periudhën trevjeçare që i paraprin procedurës së vlerësimit.		Ngarkesa mesatare e kandidatit, e vlerësuar në raport me ngarkesën mesatare të gjykatës në të cilën ai ushtron funksionin, përbën tregues të aftësisë menaxheriale në administrimin e volumit të punës, në organizimin e proceseve gjyqësore dhe në menaxhimin e kohës gjyqësore. Mbi 130% të ngarkesës mesatare të gjykatës, 3 pikë; Nga 110%–129.9% të ngarkesës mesatare të gjykatës, 2.5 pikë; Nga 100%–119.9% të ngarkesës mesatare të gjykatës, 2 pikë; Nga 80%–99.9% të ngarkesës mesatare të gjykatës, 1.5 pikë; Nga 50%–79.9% të ngarkesës mesatare të gjykatës, 1 pikë; Nën 50%–0 pikë.



B. AFTËSITË NË HARTIMIN E AKTEVE ADMINISTRATIVE (10 pikë)			Pikët total
Treguesit	Burimet	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
B.1 Kontribut në hartimin e akteve administrative të gjykatës	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		0 deri në 3 pikë, në varësi të nivelit të përfshirjes dhe rëndësisë së akteve të hartuara.
B.2 Kontribut në hartimin e projekteve ligjore që lidhen me sistemin e drejtësisë	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		0 deri në 3 pikë, në varësi të ndikimit dhe rëndësisë në sistemin e drejtësisë.
B.3 Kontribut në grupe pune për përgatitjen e udhëzimeve, rregulloreve apo akteve nënligjore në sistemin gjyqësor	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		0 deri në 2 pikë, sipas nivelit të angazhimit dhe kontributit.
B.4 Pjesëmarrje në komisione ose këshilla që kanë pasur për objekt hartimin ose shqyrtimin e akteve administrative	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		0 deri në 2 pikë, në varësi të rolit dhe përgjegjësisë në komision ose këshilla.
C. AFTËSITË NË KOMUNIKIM (15 pikë)			Pikët total
Treguesit	Burimet	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
C.1 Qartësia dhe struktura e komunikimit	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale; 3. Intervista.		Vlerësohet aftësia e kandidatit për të shprehur mendimet qartë, me gjuhë të kuptueshme dhe të saktë, për të përdorur terminologjinë ligjore në mënyrë të përshtatshme për audiencën (gjyqtarë, staf, palë, publik) dhe për të përmbledhur idetë kryesore pa u humbur në detaje teknike. • 4 pikë: komunikim shumë i qartë, i strukturuar dhe profesional në formë dhe përmbajtje; • 3 pikë: komunikim i qartë, i strukturuar dhe profesional në formë dhe përmbajtje; • 1 pikë: komunikim jo plotësisht i qartë dhe i strukturuar në formë dhe përmbajtje; • 0 pikë: mungesë qartësie dhe strukture.
C.2 Dëgjimi aktiv dhe bashkëbisedimi	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale; 3. Intervista.		Vlerësohet aftësia e kandidatit për të dëgjuar me kujdes dhe respekt mendimet e të tjerëve, për të ndërhyrë në mënyrë konstruktive gjatë diskutimeve dhe për të reflektuar mbi sugjerime apo kritika. • 3 pikë: tregon dëgjim aktiv dhe reagim të balancuar në çdo situatë komunikimi; respekton mendimet e të tjerëve dhe ndërhyrjet në mënyrë konstruktive, duke ndërtuar dialog efektiv; • 2 pikë: dëgjim i mirë dhe qëndrime përgjithësisht bashkëpunuese, por me ndërhyrje të herëpashershme të papërshtatshme ose mungesë reflektimi të plotë;



			• 1 pikë: dëgjim i pjesshëm, me prirje për të ndërprerë apo mosmarrë parasysh mendimet e të tjerëve; • 0 pikë: mungesë e dukshme e dëgjimit aktiv; nuk tregon interes për mendimet e të tjerëve dhe nuk reflekton mbi sugjerime apo kritika.
C.3 Komunikimi institucional	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale; 3. Intervista.		Vlerësohet aftësia e kandidatit për të përfaqësuar me dinjitet dhe profesionalizëm gjykatën në raportet me institucionet e tjera (KLGJ, Prokuroria, Avokati i Popullit, Dhoma e Avokatisë, Shkolla e Magistraturës etj.), për të përcjellë mesazhe zyrtare të qarta dhe për të ruajtur etikën në komunikimin institucional. • 4 pikë: përfaqësim shumë i mirë, komunikim institucional i qartë, koherent dhe gjithmonë në përputhje me etikën dhe dinjitetin e funksionit; • 2 pikë: përfaqësim i mirë, komunikim institucional i qartë, koherent dhe në përputhje me etikën dhe dinjitetin e funksionit; • 0 pikë: mungesë e aftësisë për të përfaqësuar institucionin në mënyrë profesionale; komunikim joetik ose i papërshtatshëm për nivelin institucional.
C.4 Komunikim i brendshëm	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale; 3. Intervista.		Vlerësohet aftësia e kandidatit për të komunikuar qartë dhe me respekt me gjyqtarët e tjerë dhe stafin administrativ, për të krijuar një atmosferë bashkëpunuese, për të përcjellë udhëzime të qarta dhe për të zgjidhur keqkuptimet përmes dialogut. • 4 pikë: komunikim i hapur, bashkëpunues dhe frytdhënës me stafin dhe gjyqtarët, që kontribuon në një klimë pozitive dhe efikase pune; • 2 pikë: komunikim i kufizuar që vështirëson bashkëpunimin institucional; • 0 pikë: mungesë bashkëpunimi, komunikim konfliktual ose që dëmton funksionimin normal të institucionit.
Ç. AFTËSI TË TJERA PROFESIONALE, MENAXHERIALE DHE ORGANIZIMI (5 pikë)			Pikët total
Treguesit	Burimet	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
Ç.1 Angazhim si ekspert apo lehtësues në Shkollën e Magjistraturës, në trajnime ose module që trajtojnë temat e menaxhimit të gjykatave, drejtimit institucional dhe zhvillimit të lidershipit gjyqësor	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		• 2 pikë: angazhim si ekspert në trajnime ose module që trajtojnë temat e menaxhimit të gjykatave, drejtimit institucional dhe zhvillimit të lidershipit gjyqësor; • 1 pikë: angazhimi si lehtësues në trajnime ose module që trajtojnë temat e menaxhimit të gjykatave, drejtimit institucional dhe zhvillimit të lidershipit gjyqësor; • 0 pikë: mungesë angazhimi në këtë drejtim.
Ç.2 Mbajtja e gradës shkencore, titujve akademike, ndjekja e studimeve ose specializimeve afatgjata, brenda dhe jashtë vendit, që kanë lidhje me fushën	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		• 1 pikë: zotërim i gradës shkencore ose titulli akademik me fokus lidershipin apo menaxhimin gjyqësor; • 0.5 pikë: ndjekje ose përfundim i një programi studimor të kufizuar;



e lidhshimit dhe menaxhimit gjyqësor			●0 pikë: pa gradë ose studime të lidhura me fushën.
Ç.3 Pjesëmarrje si ekspert në trajnime kombëtare ose ndërkombëtare në fushën e menaxhimit dhe drejtimit të gjykatave, pjesëmarrja në konferenca gjyqësore me fokus zhvillimin e lidhshimit në sistemin gjyqësor	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		●1 pikë: pjesëmarrje si ekspert në trajnime kombëtare ose ndërkombëtare, jashtë programit të doktoraturës, në fushën e menaxhimit dhe drejtimit të gjykatave; ●0.5 pikë: pjesëmarrja në konferenca gjyqësore me fokus zhvillimin e lidhshimit në sistemin gjyqësor; ●0 pikë: mungesë pjesëmarrjeje.
Ç.4 Zotërimi i një prej gjuhëve zyrtare të Bashkimit Evropian	1. Dokumentet të dorëzuara nga kandidati; 2. Dosja personale.		●1 pikë: zotërim shumë i mirë i një ose më shumë gjuhëve të huaja të përdorshme në komunikim profesional dhe institucional; ●0.5 pikë: Zotërim i mirë i një ose më shumë gjuhëve të huaja të përdorshme në komunikim profesional dhe institucional; ●0 pikë: Pa zotërim të gjuhëve të huaja.
D. Vizioni për drejtimin e një gjykate funksionale dhe efektive (30 pikë)			Pikët total
Treguesit	Burimet	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
D.1 Plan për mënyrën e ushtrimit të kompetencave të kryetarit të gjykatës	Platforma e paraqitur nga kandidati dhe intervista		Vlerësohet mënyra se si kandidati artikulon vizionin e tij për ushtrimin e kompetencave të kryetarit të gjykatës, duke treguar aftësi për drejtim, vendimmarrje dhe ruajtjen e pavarësisë funksionale • Qartësia dhe koherenca e planit – sa qartë, në mënyrë të strukturuar dhe të argumentuar paraqiten objektivat dhe hapat për realizimin e tyre (0–2 pikë); • Respektimi i parimeve të pavarësisë gjyqësore – në çmasë plani tregon kuptim dhe respekt për ndarjen e funksioneve dhe pavarësinë e gjyqtarëve (0–2 pikë); • Zbatueshmëria dhe ndikimi praktik – sa realiste janë masat dhe çfarë efekti pritet të kenë në funksionimin e gjykatës (0–1 pikë).
D.2 Plan për drejtimin, zhvillimin institucional dhe rritjen e efektivitetit	Platforma e paraqitur nga kandidati dhe intervista		Vlerësohet vizioni dhe aftësia e kandidatit për të drejtuar gjykatën në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme, duke paraqitur masa konkrete për zhvillimin institucional, rritjen e kapaciteteve administrative dhe përmirësimin e performancës gjyqësore në tërësi. • Qartësia dhe koherenca e strategjisë së drejtimit – qartësia në përcaktimin e objektivave dhe mënyrës së zbatimit të tyre në funksion të drejtimit efektiv të gjykatës (0–2 pikë); • Masat për zhvillim institucional dhe ngritje kapacitetshe – përfshirja e nismave për trajnime, zhvillim profesional dhe forcim të strukturave mbështetëse (0–2 pikë); • Efektiviteti dhe qëndrueshmëria e masave – vlerësimi i ndikimit të pritshëm dhe realizueshmërisë së tyre në afatmesëm



			(0–1 pikë).
D.3 Plan për organizimin dhe funksionimin e gjykatës	Platforma e paraqitur nga kandidati dhe intervista		Vlerësohet mënyra se si kandidati ka konceptuar organizimin dhe funksionimin e gjykatës, duke përfshirë aspektet administrative dhe mbështetëse që lidhen me ushtrimin e funksioneve gjyqësore. Në këtë kuadër, analizohet aftësia e kandidatit për të ndërtuar një strukturë funksionale, për të përcaktuar qartë ndarjen e përgjegjësi dhe për të siguruar koordinim efikas ndërmjet gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore. • Qartësia dhe logjika e strukturës organizative – mënyra se si paraqitet ndarja e funksioneve, përgjegjësi dhe linjave të komunikimit institucional (0–2 pikë); • Efektiviteti i masave administrative dhe menaxheriale – përfshirja e masave që rrisin rendimentin, organizimin dhe bashkërendimin e punës (0–2 pikë); • Përputhshmëria dhe zbatueshmëria – koherenca e planit me kërkesat ligjore dhe rregulloret ekzistuese, si dhe realizueshmëria praktike e tij (0–1 pikë).
D.4 Vlerësimi i situatës aktuale dhe vizioni për përmirësim	Platforma e paraqitur nga kandidati dhe intervista		Vlerësohet vizioni i kandidatit për drejtimin e një gjykate funksionale dhe efektive, bazuar në platformën e paraqitur prej tij. Në vlerësim merret parasysh niveli i kuptimit për rolin dhe përgjegjësitë e kryetarit të gjykatës, aftësia për të identifikuar sfidat kryesore të gjykatës në aspektin organizativ, administrativ dhe të funksionimit, si dhe cilësia e mendimeve dhe propozimeve të paraqitura për adresimin e tyre. Gjithashtu, vlerësohen qartësia, koherenca, struktura dhe cilësia e gjuhës së përdorur në dokument. • Kuptimi dhe analiza e rolit të kryetarit të gjykatës – niveli i qartësisë dhe thellësia e kuptimit për funksionin drejtues dhe përgjegjësitë përkatëse (0–2 pikë); • Identifikimi dhe trajtimi i sfidave kryesore – aftësia për të evidentuar sfidat kryesore të gjykatës dhe për të paraqitur masa e zgjidhje të arsyetuara (0–2 pikë); • Cilësia dhe struktura e paraqitjes së vizionit – qartësia, koherenca dhe profesionalizmi në përshkrimin e vizionit dhe masave përkatëse (0–1 pikë).
D.5 Masat për rritjen e besueshmërisë publike në sistemin gjyqësor	Platforma e paraqitur nga kandidati dhe intervista		Vlerësohet aftësia e kandidatit për të identifikuar dhe propozuar masa konkrete që synojnë rritjen e besueshmërisë së publikut në sistemin gjyqësor. Në këtë kuadër, vlerësohet niveli i angazhimit të tij për forcimin e transparencës, komunikimit publik, integritetit institucional dhe llogaridhënies së gjykatës. • Qartësia dhe koherenca e masave të propozuara – në çmasë hapat dhe nismat janë të argumentuara, të strukturuar dhe në përputhje me qëllimin e rritjes së besueshmërisë (0–2 pikë);



		• Përdorimi i mekanizmave të transparencës dhe komunikimit publik – përfshirja e praktikave të komunikimit të hapur, publikimit të vendimeve, statistikave dhe bashkëpunimit me median (0–2 pikë); • Ndikimi i pritshëm në perceptimin e publikut – vlerësimi i potencialit të masave për të përmirësuar imazhin dhe besimin e publikut ndaj gjykatës (0–1 pikë).
D.6 Evidentimi dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore në veprimtarinë gjyqësore	Platforma e paraqitur nga kandidati dhe intervista	Vlerësohet niveli i ndërgjegjësimit dhe angazhimit të kandidatit për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në ushtrimin e funksioneve gjyqësore. Analizohet aftësia e tij për të identifikuar mekanizmat e përshtatshëm që sigurojnë mbrojtjen e këtyre të drejtave, si dhe masat konkrete për evidentimin, parandalimin dhe trajtimin e shkeljeve të mundshme. • Identifikimi i mekanizmave institucionalë dhe procedural – përcaktimi i mjeteve dhe praktikave që garantojnë respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut (0–2 pikë); • Masat për ndërgjegjësim dhe zhvillim profesional – përfshirja e iniciativave për trajnime, udhëzime ose analiza të rasteve që forcojnë kulturën institucionale të respektimit të të drejtave (0–2 pikë); • Efektiviteti dhe ndikimi i pritshëm i masave – realizueshmëria e planit dhe ndikimi i tij në përmirësimin në veprimtarinë gjyqësore (0–1 pikë).
PIKËZIMI PËR PESË KRITERET E VLERËSIMIT		

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 5713, datë 26.9.2025, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Fllanza Duki, e datëlindjes 14.1.1976, dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e kërkuarit, shtetasit Shpëtim Denzi.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë

